

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY FACULTY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
OF LAW

FAKULTETI JURIDIK
STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

**Delikuenca e të miturve ne RMV-Aspekte krahasimore me Republikën e
Sllovenisë”**

KANDIDATI :

Besim Demiri

MENTORI:

Prof.Dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2020

Lënda e hulumtimit

Delikuencë (Devijim) rrjedh nga fjala latine “*deliquare*” që ka një kuptim shumë të gjerë, me këtë term kuptojmë përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Pra delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi.

Delikuenca e të miturve në të gjitha vendet e botës paraqet një problem shumë të rëndësishëm shoqëror. Në zgjidhjen e këtij problemi janë angazhuar fuqi të konsideruara individuale e shoqërore, madje edhe mjete financiare. Studimi dhe luftimi i delikuencës së të miturve në planin ndërkombëtar ka marrë aso përmasash dhe asi intensiteti sa që janë më të theksuara se në lëmit e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar. Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka egzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Kjo lloj sjellje (delikumente) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, por ajo fillon më herët, sjellja asocial fillon me nga mosha 11-14 vjeç. Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme. Mënyra e shfaqjes së sjelljeve asocial janë fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje, vjedhje, ikje nga shtëpia, ikje nga shkolla etj. Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për mënjanimin e tyre, ato sjellje kanë rritje të vazhdueshme dhe dalngadalë do të merr epitetin si “fëmijë delikuent”. Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar.

Në frymën e tendencave bashkëkohore Ligji i ri për fëmijë, i cili në Republikën e Maqedonisë gjen zbatim prej 01.12.2013 dhe i njëjti sipas nenit 19 të ligjit për drejtësi për fëmijë si të mitur e trajton çdo person deri në moshë 18-vjeçare, kurse fëmijë në rrezik e trajton çdo person i cili ka mbushur 7-vjet kurse nuk i ka të mbushur 18-vjet, në vazhdim si kategori e veçantë trajton fëmijët në rrezik i cili ka mbushur 7-vjet kurse nuk i ka të mbushur 14-vjet. Në vazhdim një

trajtim i veçantë për fëmijët në rrezik prej moshës 14-18 vjeçare. Fëmijë në përplasje më ligjin për fëmijët prej 14-16 vjeç si dhe fëmijë në përplasje me ligjin të moshës mbi 16-vjeçare.

Qëllimet e hulumtimit

Ndër format e sjelljeve të rrezikshme e të dëmshme kriminale në botën bashkëkohore konsiderohen edhe veprat penale që kryehen nga të miturit.

Veprat penale të kryera nga të mirurit cdo janë në rritje. Të dhënat statistikore japin se të miturit kryejn krime të ndryshme nga vjedhjet deri tek vrasjet mizore, të miturit kryejn këeto vepra penale nga disa faktorë të cilët do ti trajtojmë ne punimin shkencorë sic jane Faktorët ekonomik, politiko shoqërorë, mikrogruporë dhe faktorëve sociopatologjik. Gjithashtu të miturit edhe keqpërdoren dhe nxiten nga personat e moshës madhore për të kryer vepra penale.

Numri jashtëzakonisht i madh i veprave penale të kryera nga të miturit dhe shqiptimi i sanksioneve ndaj tyre , na shtynë të bejmë analizë të posacme per delikuencen e të miturve ne rethin e RMV qe ne fund te ketij punimi te dim se sa vepra penal kryhet gjate nje periudhe te caktuar kohere ng ate miturit dhe si qellim kryesore ne kete punim ti kemi masat preventive per te miturit e me pas ato represive.

Metodologjia e hulumtimit-

Në këtë studim do të përdorim metodat duke trajtuar problematikën bazë që lidhet me veprat penale kundër trafikut rrugor me theks te vaçant në ndikimin e alkoolit në sigurinë e trafikut rrugor.

Për kryerjen e studimit do të përdoren metodat si vijon:

- Metoda juridike,
- Metoda krahasuese
- Metoda historike
- Metoda statistikore

Në këtë punimin e kësaj teme do të shfrytëzohen të dhënat e gjykatave, të entit statistikorë të RMV dhe burimet e tjera zyrtare.

Rëndësia e punimit-

Delikuenca kudo në botë, në përgjithësi, shfaqet në forma përafërsisht të njëjta, por me disa veçanti që lidhen me sistemin legjislativ dhe me zhvillimin ekonomik të vendit të caktuar.

Si pasojë e multifaktorëve të ndryshëm, jeta delikuede e të rinjve duket se do jetë shumë aktive në të ardhmen, duke u bazuar në të tashmen dhe në analiza dhe tregues, të cilët tregojnë se kjo dukuri po zhvillohet vullshëm në jetën shoqërore-institucionale ku si protagonist kryesorë janë fëmijët delikuentë.

Një numër i madh i statistikave të ndryshme, të bëra nga organizata të ndryshme si dhe nga Enti statistikorë i RMV, tregojnë për rritje të numrit të rasteve delikuede nga të rinjtë në RMV. Dhe kjo është shqetësuese. Prandaj ky hulumtim shkencorë do të ketë si qëllim krucial parandalimin e delikuencës së të miturve.

Si përfundim i kësaj analize, mund të themi se delikuenca tek të miturit është një problem madhor i cili fatkeqësisht është prezentë në të gjitha shoqëritë përfshije edhe R.Maqedonise se Veriut dhe Sllovenine dhe si e tillë paraqet një sfidë serioze për tërë shoqërinë, duke përfshirë vetë të miturit, familjen, institucionet shkollore, policinë dhe të gjitha institucionet e tjera.

1. Strukturimi i punimit

PËRMBAJTJA*

- Hyrje
- Metodologjia e punimit
- Arsyeshmëria e punimit

Kapitulli I

1. Kuptimi i delikuences se te miturve.....
2. Aspekte kriminologjike të delikuences se te miturve.....
3. Aspekte sociologjike te delikuences se te miturve.....
4. Aspekte juridiko-penal i delikuences se te miturve.....
5. Karakteristika e delikuences se te mturve ne RMV-ut.....
6. Karakteristikat e delikuences se te miturve ne Slloveni.....

Kapitulli II

1. Trajtimi juridiko penal I delikuences së të miturve.....
2. Parimet bazë që u referohet personave të mitur.....
 - 2.1.Parimi i ligjshmërisë.....
 - 2.2. Parimi i humanizimit.....
 - 2.3.Parimi i pafajsisë.....
 - 2.4.Parimi i interesit më të lartë të femijës.....
 - 2.4.Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi.....
3. Konventat ndërkombëtare për trajtimin e të miturve.....
4. Aspekte krahasimore te parimeve qe trajtojn te miturit ne RMV dhe Slloveni.....

Kapitulli III

1. Profili i delikuentëve të mitur kryerësve të veprave penale
 - 1.1. Moshë e delikuentëve kryerës të mitur në RMV-ut.....
 - 1.2. Moshë e delikuentëve kryerës të mitur në Slloveni.....
 - 1.3. Gjinia e delikuentëve kryerës të mitur në RMV-ut.....
 - 1.4. Gjinia e delikuentëve kryerës të mitur në Slloveni.....
2. Gjendja ekonomike e delikuentëve kryerës të mitur në RMV-ut.....
 - 2.1. Gjendja ekonomike e delikuentëve kryerës të mitur në Slloveni.....

Kapitulli IV

1. Parandalimi i kryerjes së veprave penale nga ana e të miturve.....
2. Roli i gjykatës në parandalimin e delikuencës së të miturve.....
3. Roli i policisë në parandalimin e delikuencës së të miturve.....
4. Roli i entit social në parandalimin e delikuencës së të miturve.....
5. Roli i mas-mediave në parandalimin e delikuencës së të miturve.....
6. Aspektet krahasimore parandaluese në mes RMV-ut dhe Sllovenisë.....
7. Të dhënat hulumtuese mbi punimin.....

Hyrja

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Kjo lloj sjellje (delikuyente) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, por ajo fillon më herët, sjellja asociale dhe fillon me nga mosha shumë e re.

Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme, ndërsa mënyra e shfaqjes së sjelljeve asocial janë të dryshme, si-fyerjet, sharjet, rrahjet, mosbindje, vjedhje, ikje nga shtëpia, ikje nga shkolla etj. Dhe pikërisht për këtë arsye në këtë moshë duhet të ndërmerren masa të duhura për evitimin e këtyre sjelljeve, sjellje të cilat janë në rritje të vazhdueshme.

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar.

Kriminaliteti i të miturve në Maqedoni në teorinë penale juridike, ndryshe është i njohur si delikuencë e të miturve. Legjislacioni penal i Maqedonisë, çështjen e delikuencës së të miturve e ka rregulluar nëpërmjet dispozitave të posaçme dhe specifike në Ligjit mbi të drejtat e fëmijëve i R.Maqedonise,(Gazeta zyrtare nr.143, viti 2013),

Me nocionin kryes i veprës penale nënkuptojmë kryesit e mitur të veprave penale qofshin ata si kryes, bashkë kryes, nxitës apo ndihmës. Kryes i moshës së mitur është personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka pasur 14 vite të plota por nuk i ka mbushur 18 vite.

Të dhënat statistikore japin se të miturit kryejn krime të ndryshme nga vjedhjet deri tek vrasjet mizore, të miturit kryejn këeto vepra penale nga disa faktorë të cilët do ti trajtojmë ne punimin shkencorë siç janë faktorët ekonomik, politik, shoqërorë, faktorët mikrogrup si dhe faktorët sociopatologjik.

Numri jashtëzakonisht i madhë i veprave penale të kryera nga të miturit dhe shqiptimi i sanksioneve ndaj tyre, na shtynë të bejmë analizë të posacme per delikencen e të miturve ne qaspektin krahasues në Republikën e Maqedonisë me Republikën e Sllovenisë.

Ndaj kriminalitetit përgjithësisht, dhe kriminalitetit të të miturve nuk ka qenë immune asnjë shoqëri, pra as shoqëria Sllovene e as shoqeria ne RMV-ut. Si i tillë kriminaliteti ka qenë dhe do të jetë preokupim i shoqërisë njerëzore, përfshirë të dy vendet.

Kapitulli I

1. Kuptimi i delikuencaes se te miturve

Termi **Delikuencë** (Devijim) rrjedh nga fjala latine “*deliquare*” që ka një kuptim shumë të gjerë, me këtë term kuptojmë përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Shikuar historikisht delikuenca e të miturve është e vjetër sa edhe vetë njeriu dhe shoqëria. Pra delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi. Kjo lloj sjellje (delikumente) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, por ajo fillon më herët të shfaqet por në mënyrë më të lehtë por sjellja asocial fillon me nga mosha e pubertetit 11-14 vjeç.¹

Sipas kuptimit më të ngushtë delikuenca e të miturve përfshin vetëm sjelljet e përcaktuara me vepër penale, ndërsa deri te nocioni më i gjerë ka sjellur evoluimi i së drejtës penale për të mitur në drejtim të vënies së idesë për edukim dhe përmirësim, nëpërmjet dominimit të masave edukuese. Ky nocion është zgjeruar edhe në bazë të sjelljeve që kanë karakter të shkeljes së dispozitave tjera; kundërvajtjes, delikeve civile si dhe sjelljeve asociale që nuk janë të parapara si vepra penale por që ndikojnë në zhvillimin e të miturve.²

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Kjo lloj sjellje (delikumente) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, por ajo fillon më herët, sjellja asocial fillon me nga mosha 11-14 vjeç. Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë janë të

¹ L. Veseli, Kriminalistika e Delikuencaes së të Miturve, faqe 3

² Vllado Kambovski, E drejta penale-pjesa e përgjithshme(përkthim), Shkup 2006, faqe.1084

shumta dhe të ndryshme, ndërsa mënyra e shfaqjes së sjelljeve asocial janë fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje, vjedhje, ikje nga shtëpia, ikje nga shkolla etj.³

Sipas Kodit penal të Republikës së Maqedonisë persona të mitur konsiderohen personat prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, me një nëndarje persona të mitur të rinj prej moshës 14-16 vjet dhe persona të mitur të rinj prej moshës 16-18 vjet⁴.

Në literaturë mendohet se ligji i parë mbi delikuecën e të miturve është sjellur në SHBA në shtetin Ilionis(v. 1899), ku më pas pasoi nxjerrja e ligjeve të posaçme edhe në shtetet tjera.

Termi “i mitur” filloi të përdoret në SHBA kur shtetet federale miratuan ligjet që përcaktojnë moshën ligjore për moshën madhore. Termi “i mitur” i referohet çdo personi nën moshën ligjore të moshës madhore (moshës kronologjike në të cilën personi nuk konsiderohet më si i mitur dhe prej të cilës fillon jeta e tij si i rritur - në pjesën më të madhe të shteteve është mosha 18 vjeç).⁵

Studimet përkatëse shkencore kanë dëshmuar se personaliteti i kryerësit të mitur të veprës penale dallon në masë të madhe nga personaliteti i kryerësit madhor. Njohuritë shkencore po ashtu provojnë se procesi i rritjes dhe zhvillimit të personalitetit të të miturit nuk rrjedh sistematikisht, por me kërcime. Këto kërcime kryesisht manifestohen gjatë fazës së pubertetit dhe adoleshencës, faza këto ku te të miturit dominojnë emocionet. Këto dhe faktorë të tjerë bëjnë që të miturit të dallojnë shumë nga personat madhor.⁶

Shoqëria ka herë i ka kushtuar kujdes sjelljeve të të miturve. Shikuar historikisht, kjo dukuri ka qenë prezente në çdo shoqëri. Është me interes të përmenden mendimet e filozofit grek Sokratit i cili qysh atëherë ka konstatuar se fëmijët tani dëshirojnë luks, se ata kanë sjellje të dobëta ndaj më të vjetërve dhe më shumë dëshirojnë të flasin se sa të mësojnë, fëmijët tani nuk ngriten kur hyjnë më të vjetrit në dhomë. Me përparimin e shoqërisë edhe sjelljet e pa pranueshme shoqërore të të miturve pësuan ndryshime dhe modifikime të caktuara si në planin

³ Ismail Zejnelil- Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 19

⁴ Kodi penal i RM-së, Shkup, 1996

⁵ Ismail Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 21

⁶ Ejup Sahiti, Psikologjia gjyqësore, Prishtinë, 2007, fq. 66

e fenomenit të paraqitjes ashtu edhe në aspektin e kushteve dhe shkaqeve të cilat i shkaktjnë⁷.

Delikuenca e të miturve është dukuri shoqërore e cila manifestohet me mosrespektimin e normave morale dhe juridike. Ajo gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur, ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Delikuenca është një lloj sjelljeje në kundërshtim me normat e caktuara shoqërore.⁸ Delikuent quhet individ i cili me veprimet e veta jo vetëm që shkel normat e mjedisit, por edhe cënon të drejtat dhe liritë e tjetrit dhe bie direkt në konflikt me të tjerët. Delikuenca e të rinjve nuk paraqitet befas dhe papritur, por ka një fazë parapërgatitore, që fillon me sjellje antisociale nga mosha e pubertetit. Dihet se rritja është një proces shumë dinamik, periudha më intensive në jetën e njeriut, e cila karakterizohet me ndryshime të shumta emocionale, me përvetësimin e njohurive dhe adoptimin e zakoneve të ndryshme, qëndrimeve, gjykimeve dhe vlerave. Këto ndryshime asnjë i mitur nuk i përjeton në të njëjtën mënyrë. Disa arrijnë t'i menaxhojnë si duhet, kurse disa nuk janë të aftë t'i përballojnë dhe, shpesh kjo shërben si shkak i sjelljeve antisociale të tyre. Sjelljet antisociale të të miturve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme. Ato shfaqen në një gamë të gjerë si kryeneçësi, fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje dhe mosdurim, vjedhje, ikje nga shtëpia e nga shkolla, etj. Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për mënjanimin e tyre, ato dalëngadalë rriten e shumohen dhe bëhen potencial optimal për delikuencë të vërtetë. Kërkimet bëjnë të qartë se mbyllja e të miturve në institucione është një proces shumë i dhimbshëm për çdo të mitur; ajo dëmton zhvillimin e të miturit dhe jep efektin e kundërt në socializmin e tij. Gjithashtu, në përgjithësi, është pranuar që mohimi i lirisë rrallëherë është një masë efektive përsa i përket rehabilitimit, riintegrit dhe parandalimit të shkeljeve të mëtejshme.

⁷A.Dida. Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, Prishtinë,1996, faqe.37

⁸ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016,

2. Aspekte kriminologjike të delikuences se te miturve

Në kriminologjinë moderne kohëve të fundit delikuenca e të miturve zë gjithnjë e më tepër vend me rendësi dhe mund të thuhet se ajo ditë më ditë paraqet temë të kohës. Problemi parësor i kriminologjisë si shkencë është të gjejë shkaqet e sjelljeve kriminale të të miturve, pra të japë shpjegime etiologjike të delikuencës së të miturve si fenomen i posaçëm.⁹ Që të arrijë këtë qëllim kriminologjia si shkencë duhet ti analizojë më thellë proceset shoqërore në njërën anë dhe personalitetin e delinkuentit në anën tjetër. Gjatë shqyrtimit të kësaj teme shpesh kemi hasur në shëni- me që tregojnë jo vetëm për rritjen e këtij lloji të kriminalitetit por edhe për paraqitjen e formave të reja të delikuencës së të miturve.

Sipas studimeve të shumta empirike faktorët që ndikojnë më së shumti në paraqitjen e delikuencës janë të shumta si p.sh.: faktorët ekonomikë, socialë, kulturorë etj.¹⁰ Për dukurinë e krimit, format shkaqet, pasojat dhe parandalimin e tij, në literaturën shqiptare ka të dhëna të pakta dhe hulumtime jo të mjaftueshme ose fare gjithmon në krahasim me shtetet tjera. Disa nga këta faktorë padyshim janë: kushtet ekonomike, kushtet e jetës, kushtet familjare, mungesa e kontrollit të duhur nga ana e prindërve, përfshirja e të miturve në grupe të ndryshme, shfrytëzimin e kohës së lirë, konsumimin e alkoolit, substancave narkotike, pjekurin intelektuale etj.

Lidhur me kriminalitetin dhe shkaqet e tij, veçmas lidhur me metodat dhe mënyrën e parandalimit të tij, në literaturën kriminologjike zakonisht si nismë përmenden pikëpamjet antike të filozofëve të lashtë grekë. Mirëpo, për dukurinë e kriminalitetit, krimit dhe dënimit, ka pasur mendime dhe është folur edhe më herët, si p.sh. në Egjiptin e Vjetër, Kinën e Vjetër, Babiloninë e Vjetër etj. Mirëpo, idetë e para dhe, pak a shumë, më të sistemuara mbi kriminalitetin dhe shkaqet e tij gjenden në punimet dhe traktatet filozofike të filozofëve grekë. Në traktetet dhe punimet e këtyre filozofëve, hasen ide dhe mendime mbi kriminalitetin, shkaqet e tij dhe qëllimin e ndëshkimit. Në këtë drejtim në këto punime flitet për shkaqet dhe arsyen e marrjes së individëve me sjellje kriminale. Kështu, ata kanë shtruar nevojën e shqyrtimit dhe studimit të arsyes së marrjes së personave të tillë me sjellje kriminale.

⁹ Ismail. Z, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, faqe 46

¹⁰ Po aty

Posaçërisht disa prej këtyre filozofëve janë angazhuar për eliminimin e dënimeve të ashpra ndaj kryesve të veprave penale. Për këtë, arsye në literaturën kriminologjike, këto ide dhe mendime të këtyre filozofëve trajtohen si përpjekje të para për hulumtimin dhe shqyrtimin e shkaqeve të kriminalitetit. Mirëpo, shpjegimet dhe trajtimet e tyre prezantojnë më tepër karakteristikat e spekulimeve filozofike sesa paraqesin ndonjë teori të veçantë shkencore mbi kriminalitetin. Në literaturën kriminologjike si nismëtarë të ideve mbi studimin dhe hulumtimin shkencor të kriminalitetit merren filozofët e njohur grekë Platoni dhe Aristoteli.¹¹

3. Aspekte sociologjike te delikuencaes se te miturve

Aspekti sociologjik në të hulumtuarit e sjelljeve të delikuencës së të miturve, duhet të ndricojë, së pari, kushtet shoqërore të tyre, me shënime të sakta mbi rrethin familjar, shfrytëzimin e kohës së lirë, konsumimin e alkoolit, substancave narkotike, pjekurinë intelektuale, etj. Edhe Hans Von Heting, njëri prej teorikëve më eminent në të kuptuarit dhe të interpretuarit e sjelljeve delikuede, pikëpamjet e veta i ka mbështetur kryesisht në faktorët sociologjik, me të cilët tregon se ato sjellje janë gjithnjë të lidhura me shkaqet sociale dhe konstelacionin e faktorëve individual dhe atyre shoqëror¹².

Koncepti kryesor dhe vendimtar në shkollën sociologjike është se faktori dominant në sjelljet e këtilla të të miturve gjendet jo vetëm në faktorin endogjen biopsiqik por, edhe në faktorin shoqëror. Sipas kësaj, rëndësi të posaçme në shfaqjen e veprave penale nga ana e të miturve kanë faktorët e jashtëm veçanërisht faktorët shoqëror dhe rrethanat e tjera në të cilat kryerësi i veprave penale jeton dhe vepron¹³.

Shkolla sociologjike e hedh idenë për kriminel të lindur, duke i klasifikuar delikuentët në dy kategori: të rastit apo akut, në të cilët pas veprës penale qëndrojnë disa faktorë momentalë, kurse vetë vepra nuk është specifike për personalitetin e kryesit, në çka kjo kategori ndahet në

¹¹ Ismail Zejneli, veper e cituar, Delikuenca e te miturve, Tetove, 2018

¹² A. Dida, Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, Prishtinë, 1996, faqe 59

¹³ Po aty

dy nëngrupe: të *përmirësueshëm*, në të cilët mund ndikohet në mënyrë përmirësuese me dënim dhe *delikuentë të papërmirësueshëm*, të cilët duhet të neutralizohen.¹⁴

4. Aspekte juridiko-penal i delikuences se te miturve

Pozita penalo-juridike e të miturve është vetëm një rrethanë që kushtëzon zbatimin e masave të legjislacionit penal si mjet i fundit në luftimin e delikuencës së të miturve. Legjislacioni penal, edhe pse dukshëm e ka rregulluar pozitën penalo-juridike të të miturve, nuk ka arritur sa duhet të ndikojë në luftimin më të suksesshëm të delikuencës së të miturve. Mirëpo, edhe normat penalo-juridike më bashkëkohore nuk do të kenë efekte të pritura kriminalo-politike, nëse njëkohësisht nuk bëhen përrirje përkatëse kadrovike, organizative dhe normative në zbulimin, gjykimin e të miturve dhe ekzekutimin e sanksioneve ndaj tyre¹⁵.

I mitur është personi i cili e ka mbushur moshën 14-vjecare por nuk e ka mbushur moshën 18-vjec (Kodi i të miturve i Kosovës).

“ Në të drejtën penale një kohë të gjatë mbisundon ideja se të miturit nuk duhet të ndahen prej kryerësve të rritur edhe pse në të drejtën romake ka ekzistuar dallimi i kryerësve sipas moshës. Ligji i XII tabelave për dy vepra, vjedhje publike dhe dëmtim të rendimenteve bujqësore për të mitur(*impuberes*), ka përcaktuar dënime të posaçëm-rrahje, sipas vlerësimit të gjyqtarit dhe kompenzim të dëmit. Por për herë të parë me *kodifikimin e Justinianit* është vendosur kufiri preciz ligjor mes të miturve (*impuberes*) dhe kryerësve të rritur (*puberes*) në katërmbëdhjetë vjet për të mitur dhe në dymbëdhjetë vjet për të mitura. Ka ekzistuar sistem i vetëm i sanksioneve me atë që fëmijët e vegjël kanë qenë të “kursyer”nga zbatimi i dënimit, nëse gjyqi nuk konstaton se janë të dëmshëm (këqinj). Kuptimi për të mitur si kriminel në miniatyrë, prej të cilës rezultojnë edhe barazimet në trajtimin penalo-juridik, atëherë është mbështetur në maksimën sunduese: *militia supplet aetatem (tw keqen e kompenzon moshën)*”.¹⁶

¹⁴ Vlado.K, E drejta penale(perktim), Shkup,2007,

¹⁵ Vesel Latifi, E drejta,nr.1–Prishtinë, 1997, faqe , 28

¹⁶ V.Kambovski, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, përkthim, Shkup, 2006, faqe.596

Në literaturë mendohet se ligji i parë mbi delikuencën e të miturve është sjellur në SHBA në shtetin Ilionis(v. 1899), ku më pas pasoi nxjerrja e ligjeve të posaçme edhe në shtetet tjera

“Nëse shikojmë fenomenologjinë e sjelljeve delikuede të të miturve, vërehet se ajo konsiston në ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të ndryshme që pak a shumë janë të ngjashme me kriminalitetin e personave të rritur, por kuptohet se në raste konkrete, ka edhe disa veçori të theksuara, kështu që nga të dhënat e kërkimeve kriminologjike dhe nga praktika gjyqësore, vërehet se delikuentët e mitur dukshëm marrin pjesë në kriminalitetin kundër pasurisë, në kriminalitetin e trafikut, në kryerjen e krimeve në grupe dhe shoqata të ndryshme kriminale, në aktivitetin rreth shpërndarjes dhe konsumimit të drogës, në veprime tjera të dhunës, e sidomos në krimet kundër jetës dhe trupit dhe në deliktet seksuale. Posaçërisht theksohet se veprimet e këtylla delikuede të të miturve janë në ekspansion të përhershëm dhe në kryerjen e veprimeve të tilla vërehet vrazhdësia dhe përdorimi i theksuar i dhunës”¹⁷.

5. Karakteristikat e delikuencës së të miturve në RMV

Karakteristikat themelore të delikuencës së të miturve në shoqërinë bashkëkohore është se ajo gjendet në rritje të përhershme dhe se manifestohet me forma të paraqitjes që janë mjaft të rrezikshme, për çka edhe delikuenca e të miturve sot është një preokupim i madh në shumë vende. Kjo ka të bëjë në rend të parë me studimin dhe analizën e shkaqeve dhe të burimeve të cilat sjellin deri te delikuenca e të miturve në njërin anë si dhe në anën tjetër vërehet një përpjekje dhe angazhim për gjetjen e metodave, mjeteve dhe mënyrave më të përshtatshme për pengimin e saj.¹⁸

Karakteristikat e delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut kohëve të fundit është se kjo dukuri është në rritje.

Rritja e delikuencës së të miturve në një shoqëri është e ndërlidhur me kushtet e veçanta shoqërore si problemet ekonomike të cilat lindin nga niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, këto shoqëri karakterizohen me varfëri në masë të gjerë e cila determinon nivelin e lartë të

¹⁷ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 227

¹⁸ Halili, R- Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 224

papunësisë kjo përcillet me rritjen e numrit të popullsisë e cila lindë si pasojë e mosplanifikimit të familjes dhe rritjes së numrit në veçanti industrializimi me evolucionin e tij gjithnjë e më tepër kushtëzon zvogëlimin e numrit të punëtorëve që detyron bartësin e familjes ta detyrojë të migrojë për të gjetur ambiente më të favorshme për ekzistencë materiale. Këto dukuri determinojnë urbanizim të hovshëm degradimin e familjes erozionin e vlerave etike tradicionale padyshim të ndikuara edhe nga mjetet e informimit publik, angazhimi jo adekuat i organeve sociale dhe pjesëmarrja e tyre në zgjidhjen e problemeve sociale si dhe reformat e vonuara arsimore dhe aftësia e tyre për t'u përgjigjur sfidave bashkëkohore.¹⁹

Koncepcioni material e formal i delikuencës së të miturve në çfarëdo mase që ky koncepton të përfshijë elementet dhe karakteristikat përkatëse, do të duhej të përmbante në vete specifikat e një lloji të veçantë të kriminalitetit, të cilin e kryejnë personat e moshës së mitur.²⁰

6. Karakteristikat e delikuences se te miturve ne Slloveni

Shkaqet e delikences së të miturve në Slloveni përgjithësisht janë të ngjajshme me shkaqet e delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe më gjerrë.

Mendohet se shkaqet e delikuencës së të miturve janë të ngjashme me shkaqet e delikuencës së të rriturve, mirëpo në literaturë theksohen disa faktorë që deri diku janë më tipik për këtë moshë të delikuentëve. Kështu, posaçërisht si faktorë përmenden: ambienti familjar, edukata familjare, familja deficiente, kushtet ekonomike, ndikimi i dëmshëm i rrugës, lëvizjet e popullatës fshat-qytet, migrimi, procesi i edukimit dhe i arsimimit, ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv sidomos ndikimi i shtypit revial, televizionit, filmit dhe literatures.²¹

Dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodi Penal Slloven²² do të zbatohen gjithashtu për veprat penale të përcaktuara me ligje të tjera ose traktate ose akte ndërkombëtare të ratifikuara dhe botuara të Bashkimit Evropian, përveç nëse parashikohet ndryshe nga këto akte.

¹⁹ Владо, К & Татјана, В- Малолетничка правда, Закон за малолетничка правда со коментари, страна 17

²⁰ Vesel, L- Kriminalistika e delikuencës së të miturve, fq. 44

²¹ Po aty

²² N.9 I Kodit penal Slloven

Nëse ligjet që përcaktojnë përgjegjësinë penale për të mitur, persona juridikë ose lloje të tjerë të veçantë të kryerësve ose veprime (ligje të veçanta penale) përmendin në dispozitat e përgjithshme zbatimin e njëkohshëm të pjesës së përgjithshme të Kodit penal Slloven, do të zbatohet kodi i fundit i vlefshëm.

Në rastet kur një vepër penale sipas kapitujve kundër jetës dhe trupit, kundër të drejtave dhe lirive të njeriut, kundër integritetit seksual ose një vepre tjetër penale sipas këtij Kodi me shenja dhune është kryer kundër një të mituri, dispozitat e këtij Kodi për ngritjen e një mocioni nuk zbatohen për metodën e ndjekjes penale.²³

Rezultatet për vitet, (2009, 2010, 2011 a) Kodi Penal në fuqi deri në Nëntor 2008 (Kazenski zakonik, KZ): Në vitin 2009, procedurat ndaj shtatë të rriturve ishin përfunduar para senatit të gjykatës, ndërsa, në vitin 2010, ishin pesë të rritur kundër të cilëve përfunduan procedurat para senatit të gjykatës. Në të dy vitet e përmendura nuk pati raste në të cilat ishte vendosur një gjobë, poashtu, në 2009 dhe 2010, asnjë i mitur nuk iu nënshtrua procedurave të tilla.²⁴

Dispozitat e neneve 70 deri 94, të Kodit Penal zbatohen ndaj të miturve dhe kanë të bëjnë me shqiptimin e burgimit për të mitur.

Kohëzgjatja e një procedure ishte ndërmjet katër dhe gjashtë muaj, ndërsa dy të rritur u përballën me procedura që zgjasnin nga dy deri në katër muaj. Në vitin 2009, asnjë i mitur nuk iu nënshtrua procedurave të tilla. Ndërsa në vitin 2010, trupi gjykues e përfundoi procedurën kundër një të mituri, dhetë njëtit iu shqiptua masa edukative, përkatësisht iu dhanë edhe udhëzime dhe ndalime, ndërsa kohëzgjatja e procedures ndaj të miturit rezultoi të ishte midis muajve të një viti.

²³ Po aty,

²⁴ Slloveni, Akti i Ndihmës Ligjore Falas, 31 maj 2001. (dhe modifikimet pasuese)

Të gjithë personat e shpallur fajtorë në 2009 dhe 2010 ishin meshkuj, dhe të gjithëve iu ishte shqiptuar dënim me kusht, ndërsa në vitin 2009, asnjë i mitur nuk iu nënshtrua procedurave gjyqësore për vepra të kryera penale.

Në vitin 2010, u zhvillua procedura gjyqësore kundër një të mituri, dhe pas përfundimit të séances gjyqësore, të njëtit iu shqiptua sanksioni ndaj të miturve- masa edukative, përkatësisht u dhanë edhe udhëzime dhe ndalime.

Kapitulli II

1. Trajtimi juridiko penal I delikuentes së të miturve

I mitur është çdo person deri në moshën 18 vjeçare (neni 12 i Ligjit mbi drejtësinë për të mitur i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.87/2007).

Në nenin 12, të ligjit për të miturit, të Republikës së Maqedonisë i vitit 2008, janë të paraqitura nocionet e caktuara dhe shprehjet që e kanë kuptimin si vijon:²⁵.

- i mitur është çdo person deri në moshën 18 vjeçare, i cili sipas Konventës për të drejtat e fëmijës konsiderohet si fëmijë; .

- fëmijë në rrezik është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprës që me ligj është e përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur katërmëdhjetë vjet; fëmijë në rrezik konsiderohet edhe i mituri deri në moshën 14 vjeçare-i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotropike ose alkoolit, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmija-viktimë i dhunës dhe fëmija i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes, ose fëmija nuk është përfshirë në sistemin e arsimit dhe edukimit ose është dhënë pas lypësisë, bredhjes ose prostitucionit, i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie në kundërshtim me ligjin.

- i mitur i ri është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, i ka mbushur katërmëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet;

²⁵ Ligji mbi drejtësinë për të mitur i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr.87/2007.

- i mitur i ri në rrezik është personi i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale, për të cilën është paraparë dënim me të holla ose dënim me burg deri në tri vjet ,ose kundërvajtje, ka mbushur katërmëdhjetë vjet, kurse nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet; ose që është i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotrope ose alkoolit; fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmijë i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social , që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes, i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie në kundërshtim me ligjin

- i mitur i rritur është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet;

Ndërsa sipas, neni 19, të ligjit mbi të drejtat e fëmijëve²⁶ shprehjet, nocionet e përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim;

-fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjet,

-fëmijë në rrezik konsiderohet çdo fëmijë i cili i ka mbushur shtatë vjet por nuk i ka mbushur 18 vjet, i cili ka paaftësi fizike apo mentale, një viktimë e dhunës në familje, jo i edukuar dhe socialisht jo i favorizuar, i cili është në atë gjendje sa që është e vështërë ose e pamundur realizimi i funksionit edukues të prindërve, kujdestarëve, që nuk janë të përfshirë në sistemin edukues, që janë të dhënë pas lëmoshës apo prostitucionit, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotropike apo alkool, dhe për shkak të këtyre kushteve mund të vije në kontakt me ligjin si viktimë ose si dëshmitarë i një veprimi që me ligj është e paraparë si kundërvajtje ose si vepër penale.

-fëmijë në rrezik deri në 14 vjet, konsiderohet çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është e përcaktuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me të holla apo dënim me burg mbi tre vjet, apo veprim që me ligj është përcaktuar si vepër

²⁶ Ligjit mbi të drejtat e fëmijëve i R.Maqedonise,(Gazeta zyrtare nr.143, viti 2013)

kundërvajtëse nëse i ka mbush shtatë, por nuk i ka mbushur 14 vjet.

- fëmijë në rrezik prej 14 vjet-18 vjet, konsiderohet çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është e përcaktuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me të holla apo dënim me burg mbi tre vjet, apo veprim që me ligj është përcaktuar si vepër kundërvajtëse, nëse i ka mbush 14 vjet, por nuk i ka mbushur 18 vjet.

-fëmijë në konflikt me ligjin prej 14vjet -16 vjet, konsiderohet çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është e përcaktuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi tre vjet nëse i ka mbush 14 vjet, por nuk i ka mbushur 16 vjet.

-fëmijë në konflikt me ligjin prej mbi 16 vjet, konsiderohet çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është e përcaktuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi tre vjet nëse i ka mbushur 16 vjet, por nuk i ka mbushur 18 vjet.

-fëmijë viktimë konsiderohet çdo fëmijë deri në 18 vjet, të cilët kanë pësuar dëmtime, përfshirë ato fizike dhe mentale, vuajtje emocionale, humbje materiale apo dëmtime tjera, rrezikimi i të drejtat, si rezultat i pasojave të kryerjes së veprimeve që me ligj është e përcaktuar si vepër penale.

- Madhor i ri – personi i cili në kohën e gjyimit për veprimet e kryerjes së veprës që me ligj është e përcaktuar si vepër penale i ka mbushur 18 vjet por nuk i ka mbushur 21 vjet.

-Masat-janë masa të ndihmës dhe mbrojtjes të përcaktuara me ligj të cilat nuk përbëjnë kufizimin dhe shkeljen e lirive dhe të drejtave të fëmijëve që për shkak të kryerjes së veprimeve me ligj është përcaktuar si vepër penale, vepër kundërvajtëse apo gjendje të rrezikut, të cilat ndaj fëmijës, prindërve, apo kujdestarit mund ti zbatojë gjykata apo organet tjera të përcaktuara me ligj.

-Sanksionet janë pasoja juridike të veprimit të përcaktuar me ligj si vepër penale apo kundërvajtje, e cila përbëhet në ndihmë dhe mbrojtje apo në kufizim apo marrjen e disa të drejtave dhe lirive të fëmijëve në moshën 14-18 vjet, për shkak të veprimit të kryer e parashikuar si vepër penale ose kundërvajtje, të cilën e shqipton gjykata në procedurë të

përcaktuar me ligj.

-Gjykatë kompetente- gjykatës për fëmijë dhe këshilli për fëmijë,

- Organe tjera të specializuara- janë qendrat për punë sociale, prokuroria publike, Ministria e punëve të mbredshme, dhe entet për ekzekutimin e sanksioneve për fëmijë dhe

-Familje- janë prindërit, apo kujdestar i fëmijës, të afërmit e gjakut në vijë të drejtë, vëllau, motra, bashkëshorti, si dhe personat tjerë me të cilët fëmiju jeton në familje të përbashkët.

Në Kodin penal të RM-së janë paraparë disa dispozita që parashohin ndëshkimin për personat të cilët veprojnë në shoqata kriminale, neni 394-shoqërimin kriminal; neni 394-a organizatën terroriste; neni 416 shoqërimin për veprimtari armiqësore; neni 418, organizimin e grupit për të kryer veprën tregti me njerëz. Vepra të posaçme kriminale janë edhe veprat e parapara me nenet: 215 rrjeti i organizuar i shitësve ose ndërmjetësuesve të drogave narkotike; neni 277 organizimi i rrjetit të shitësve ose ndërmjetësuesve të vepra tregti e palejuar; neni 278 banda e organizuar, grupi ose shoqata tjetër për kontrabandë.

Sipas n.71, të Kodit Penal të Republikës së Sllovenisë nuk mund të shqiptohet sanksion penal kundër të miturve nën moshën 14-vjeçare në kohën e kryerjes së veprave penale.

Sipas n.72, të Kodit penal të Republikës së Sllovenisë, kundër të miturve që në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur 14 vjet por ende nuk e ka arritur moshën 16 vjeçare, mund ti shqiptohen vetëm masat edukuese.

Qëllimi i masave edukuese është që të miturit ti sigurohet edukimi, zhvillimi i duhur personal, ndryshimi i tij, asistencë, mbrojtje dhe ndihmë në zhvillimin e tij.

2. Parimet bazë që u referohet personave të miturve

2.1.Parimi i privimit të lirisë së të miturve-

Privimi nga liria të miturve do tu shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm.²⁷ Gjate kohës se privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.

Sipas Rregullat e Kombeve të bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës),

- heqja e lirisë është masa e fundit dhe kjo duhet të ketë kohëzgjatje të kufizuar;
- heqja e lirisë për të miturit nuk mund të bëhet pa një motiv juridik objektiv;

Neni 37 i KDF-në Shqipëri, ka në përmbajtjen e vet- ndalimin e torturës dhe trajtimit mizor, degradues, çnjerëzor. Nuk duhet të ketë as dënim kapital as dënimit me vdekje dhe as burgim të përjetshëm për fëmijët; arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore, duhet të jetë i veçuar nga të rriturit dhe duhet të jetë gjithnjë në kontakt me familjen e tij; fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për asistencë juridike dhe të drejtë për të kundërshtuar privimin e lirisë dhe të merret një vendim i shpejtë në lidhje me çështjen, etj.

Standardi i trajtimit të veçantë dhe dinjitoz të çdo fëmije të dyshuar, akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, me qëllim që të zhvillohen ndjenjat e dinjitetit dhe të vlerës së personit, të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke marrë parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj (neni 40/1 KDF).

²⁷ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq-31

2.2. Parimi i ndalesës së torturës, sjelljes mizore dhe johumane

Ky parim po ashtu paraqet parim qenësor, i garantuar me dokumente të shumta ndërkombëtare, prej të cilave si më i rëndësishëm paraqitet Konventa evropiane për të drejtat e njeriut. Kjo e drejtë është po ashtu e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Në pajtim me këtë parim asnjë fëmijë nuk guxon të ekspozohet në mizori ose veprime tjera mizore, johumane ose sanksione. Fëmija po ashtu ka të drejtë për mbrojtje të fuqizuar nga tortura ose procedura tjera johumane, nënçmuese ose nga sanksione.²⁸

2.3. E drejta për të qenë i/e informuar

Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, prindërit ose tutorët e tyre dhe përfaqësuesit ligjorë, qysh nga kontakti i tyre i parë me sistemin gjyqësor, duhet të informohen me kohë dhe në mënyrë adekuatë në lidhje me të drejtat e tyre e deri te shkalla e mundshme dhe adekuate, mes tjerash edhe për:²⁹

- Qasjen në shërbimet shëndetësore, psikologjike, sociale dhe shërbime tjera relevante, si dhe mjete për qasje në shërbime të tilla, së bashku me mbështetje juridike dhe forma tjera të mbështetjes këshillëdhënëse ose përfaqësim, kompensim dhe mbështetje urgjente financiare, aty ku është e zbatueshme,
- Procedura për procesin juridiko-penal për të rritur dhe persona të mitur, duke përfshirë edhe rolin e fëmijëve viktimë ose dëshmitarë, rëndësinë, kohën dhe llojin e dëshmisë, si dhe për mënyrat e “marrjes në pyetje” do të realizohet gjatë hetimit dhe gjykimit,
- Mekanizmat ekzistuese për mbështetje të fëmijës, kur dorëzon ankesa dhe merr pjesë në hetim dhe procedurë gjyqësore;
- Vendet dhe koha specifike e marrjes në pyetje dhe ngjarjet tjera relevante;

²⁸ PROCEDURA për veprim me fëmijën – viktimë. – Kavadarë: Këshilli për parandalim të delikuencës së të miturve - KPDM, 2014.

²⁹ Po aty

- Qasje në masa të mbrojtjes;
- Mekanizmat ekzistuese për rishikim (revidim) të vendimeve, të cilat ndikojnë te fëmijët viktimë dhe te dëshmitarët;
- Të drejtat relevante të fëmijëve viktimë dhe dëshmitë në pajtim me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe Deklaratën për parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit.

2.4. E drejta për jetë private

Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.³⁰

Sipas nenit 11 të KDPM të R.Shqipërisë, Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësi prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të mituri. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës. E drejta e fëmijëve për mbrojtjen e jetës së tyre private gjatë gjithë fazave të procedimit reflekton të drejtën e fëmijëve për privatësi siç është paraparë në nenin 16 të KDF. Termi “Në të gjitha fazat” përfshin, kontaktin fillestar me policinë (p.sh kërkesa për informacion dhe identifikim) deri në vendimin përfundimtar, i cili jepet nga një autoritet kompetent, apo lirimi nga mbajtja në

³⁰ n.16.1, I Konventes për të Drejtat e Fëmijëve

burgim apo supervizim. Në këtë kontekst të veçantë, kjo e drejtë nënkupton shmangien e çdo lloj dëmtimi, i cili mund të rezultojë nga publiciteti i padëshiruar apo nga procesi i etiketimit.

Në mënyrë që të mbrohet e drejta e privatësisë së fëmijës, shtetet mund të parashikojnë si përjashtim, që gjykatat ose seancat dëgjimore për një fëmijë të akuzuar për shkelje penale të organizohen me dyer të mbyllura. Seancat publike në rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin duhet të jenë vetëm në raste të veçanta, bazuar në një vendim të shkruar të gjykatës. Ky vendim duhet të jetë i mundshëm për t'u apeluar.(n.60).

Gjykata dhe organet tjera, të cilat marrin pjesë në procedurë e kanë për detyrë të sigurojnë mbrojtje të privatësisë së fëmijës dhe familjes së tij. Kur i gjykohet fëmijës, gjithnjë përjashtim
PROCEDURA PËR VEPRIM ME FËMIJËN-VIKTIMË 33 tohet publiku. Rregulli i njëjtë vlen edhe kur jep deklaratë fëmija viktimë e veprës penale, kur përjashtohet publiku. Publiciteti i plotë i procedurës penale, në të cilën paraqitet fëmija si viktimë e veprës penale, do të ishte kundërproduktiv ndaj interesave të fëmijës.³¹

2.3.Parimi i pafajsisë

Personi i akuzuar për vepër penale, do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk do të vërtetohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. Personi i privuar nga liria, i paraburgosur në mënyrë të paligjshme, ose i dënuar në mënyrë të paligjshme, ka të drejtën e kompensimit të dëmit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj.(n.13 I Kushtetutës së RMV-ut).

Çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe cdo dyshim për akuzën ndaj të miturit çmohet në favor të tij.

Sipas n.15, të Kushtetutës së Sllovenisë, garantohet mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe e drejta për të korrigjuar pasojat e shkeljes së tyre.

³¹ PROCEDURA për veprim me fëmijën – viktimë. – Kavadarë: Këshilli për parandalim të delikuencës së të miturve - KPDM, 2014.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit. Askush nuk mund të privohet nga liria, përveç në rastet dhe sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

Kushdo që është i privuar nga liria do të informohet menjëherë, në gjuhën e tij amtare ose në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e heqjes së tij nga liria. Ai gjithashtu duhet të informohet me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur pse është privuar nga liria. Ai duhet të informohet menjëherë se nuk është i detyruar të deklarojë asgjë, se ka të drejtë për ndihmë të menjëhershme juridike nga një avokat i zgjedhur prej tij dhe se autoriteti kompetent është i detyruar të informojë të afërmit e tij për heqjen e lirisë me kërkesën e tij.(n.19, I Kushtetutës së Slovenisë).

Një person për të cilin ekziston dyshimi i arsyeshëm se ai ka kryer një vepër penale mund të ndalohet vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor, kur kjo është e domosdoshme në mënyrë të pashmangshme për rrjedhën e procedurave penale ose për sigurinë e njerëzve.(n.20, I Kushtetutës së Slovenisë).

Sipas n.27, të Kushtetutës së Slovenisë, çdo kush që akuzohet për një vepër penale, do të konsiderohet i pafajshëm (presumohet i pafajshëm) derisa të vërtetohet fajësia me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Standardi i trajtimit të veçantë dhe dinjitoz të çdo fëmije të dyshuar, akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, me qëllim që të zhvillohen ndjenjat e dinjitetit dhe të vlerës së personit, të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke marrë parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj. (neni 40/1 KDF-Shqiperise).

2.4.Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh: ³²

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore. Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.

2.5.Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi

Të drejtat e njeriut janë një pjesë e rëndësishme e teorive të së drejtës dhe një koncept i rëndësishëm filozofiko-politik.Mes të drejtave themelore të qenies njerëzore janë e drejta e lirisë individuale, e drejta për jetën, e drejta e vetvendosjes, e drejta e fesë etj.³³ Sidoqoftë, të drejtat e njeriut mund të ngatërrohen mes vete; ato kufizohen nga të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose nga kërkesat morale, publike, ose të rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme të një shoqërie deomokratike.

Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, pozitës pronësore ose shoqërore(n.54, I Kushtetutes se Republikess e se Maqedonise se Veriut).

³² Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve- vepër e cituar, n. 10 te KDPM të R.Shqipërisë,

³³ Wikipedia, të drejtat e njeriut

Parimi i mosdiskriminimit është i rëndësishëm për t'u mbajtur parasysh nga ana e avokateve si në aspektin e ofrimit të shërbimit pa dallim dhe performancës së mbrojtjes klienteve të cilët u përjasin grupeve të ndryshme shoqërore apo pakicave të caktuara. Gjithashtu, fëmijët në konflikt me ligjin, shpesh janë viktimë të diskriminimit për kur ata duan të kenë akses në edukim, në tregun e punës. Për këtë arsye, duhet të merren masa për parandalimin e diskriminimit, duke i siguruar atyre suportin dhe mbështetjen e nevojshme në përpjekjet e tyre për t'u riintegruar në shoqëri.³⁴

Të drejtat e fëmijës duhet të garantohen pa asnjë lloj diskriminimi mbi baza gjinore, racore, ngjyre apo përkatësie etnike, moshe, gjuhe, besimi fetar, bindje politike, kombësie, gjendje social-ekonomike, pasurore, lindje, orientimi seksual etj.³⁵ Mbrojtje e veçantë duhet t'i sigurohet fëmijëve nga grupe, si emigrantë, refugjatë, azilantë, fëmijë të pashoqëruar, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë të pastrehë, fëmijë të rrugës, fëmijë nga komuniteti rom si dhe fëmijë në institucione rezidenciale.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë përkufizohet më nënë mënyrë të ngjashme nga KEDN-ja dhe e drejta e BE-së. Neni 2(2) i Direktivës së BE-së për Barazimin Raciale thotë se diskriminimi i drejtpërdrejtë "ndodh kur një person trajtohet, është trajtuar ose do të trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një tjetër.

3. Konventat ndërkombëtare për trajtimin e të miturve

Të drejtat e të miturve janë të përcaktuara edhe me Konventa ndërkombëtare, kështu Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Të miturit, e cila u miratua në vitin 1989, është traktat i parë ndërkombëtar që merret me mbrojtjen e plotë të drejtave të të miturve. Konventa është një udhëzues se si të miturit duhet të trajtohen dhe të mbrohen. Një organ i posaçëm ndërkombëtar i Komitetit të OKB-së mbi të Drejtat e të miturit monitoron zbatimin e Konventës në shtetet që e kanë ratifikuar atë. Konventa mbi të Drejtat e të miturve do të shërbejë të gjithë atyre që punojnë me të miturit, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes angazhimit

³⁴ n.2, I Konventës për të Drejtat e Fëmijëve

³⁵ Udhëzimet e Këshillit të Europës mbi Drejtësinë Miqësore për Fëmijët

profesional vijnë në kontakt me të miturit: prindërit, mësuesit, edukatorët, zyrtarë të lartë të shtetit, punonjës të kujdesit shëndetësor dhe punonjës social, juristë, gjyqtarë, oficerë të policisë. Konventa iu dedikohet edhe të miturve. Të miturit kanë nevojë të dinë të drejtat e tyre që iu takojnë nga lindja. Nëse janë të përkushtuar për respektimin e të drejtave të tyre, të miturit zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për respektimin e të drejtave të të tjerëve. Kur marrin pjesë në vendimmarrje, mësojnë të marrin përgjegjësi për realizimin e tyre. Duke njohur dhe duke u angazhuar për të drejtat e tyre, të miturit arrijnë të vetëdijesohen se këto të drejta iu takojnë edhe të tjerëve.³⁶

3.1. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë. Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi.

Fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit.

Për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës.

Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese(n.3)

³⁶ Ismail Zejneli, veper e cituar, fq-33-34

Në të gjitha vendimet e marra në kontekstin e administrimit të drejtësisë për të mitur, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. Fëmijët ndryshojnë nga të rriturit për shkak të zhvillimit të tyre psikologjik dhe emocional si dhe për shkak të nevojave emocionale dhe edukative. Kjo diferencë përbën bazën për një shkallë fajësie me të vogël për fëmijët në konflikt me ligjin. Këto dhe ndryshime të tjera janë arsytet për një sistem drejtësie për të mitur të veçantë dhe për një trajtim të ndryshëm për fëmijët. Interesi më i lartë i fëmijës do të thotë për shembull se qëllimi tradicional i dënimit, ndëshkimi i autorit, duhet të zëvendësohet me qëllimet e rehabilitimit dhe dëmshtëpërblimitit në raste e fëmijëve autorë të veprave penale. Kjo duhet të bëhet duke patur parasysh edhe sigurinë publike.(n.10).

3.2. Konventa Europiane për “marrdhëniet me fëmijë”

Marrdhënia ndërmjet një fëmije dhe prindërve të tij ose të saj

Një fëmijë dhe prindërit e tij ose të saj kanë të drejtë të marrin dhe të mbajnë marrdhënie të rregullta me njëri tjetrin. Këto marrdhënie mund të kufizohen ose përjashtohen kur kjo kërkohet nga intereset e larta të fëmijës. Kur nuk është në favor të interesave të larta të një fëmije që ky të mbajë marrdhënie të pambikëqyrura me një nga prindërit e tij, konsiderohet mundësia e marrdhënieve personale të mbikëqzrura ose forma të tjera të marrdhënieve me prindërin (n.4)

E drejta e fëmijës për tu informuar, konsultuar dhe shprehur mendimin e tij ose të saj

Fëmija që në bazë të së drejtës ndërkombëtare konsiderohet me zhvillim të plotë mendor ka të drejtë, përveç kur një gjë do të ishte haptazi në dëm të interesave të larta të tij ose të saj-

- të marrë të gjitha informacionet përkatëse,
- të konsultohet,
- të shpreh mendimin e tij ose të saj(n.6)

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me marrdhëniet

Gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me marrdhëniet, organet gjyqësore marrin të gjitha masat-

-për të siguruar që të dy prindërit të jenë të informuar për rëndësinë e vendosjes dhe të mbajtjes së marrdhënieve të rregullta me fëmijën e tyre, për fëmijen dhe për atë vet,

-për të nxitur prindërit dhe personat tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët për të lidhur marrëveshje miqësore në lidhje me marrëdhëniet sidomos duke përdorur ndërmjetësimin familjar ose ndonjë formë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve,

-para marrjes së një vendimi, të sigurohen që disponojnë informacion të mjaftueshëm, sidomos nga ata që mbajnë përgjegjësi familjare, me qëllim që të marrin një vendim në favor të interesave të larta të fëmijës dhe kur është e nevojshme të marrin informacion shtesë nga organet ose personat e tjerë kompetent(n.7)

Kapitulli III-të

3. Profili i delikuentëve të mitur kryerësve të veprave penale

Nuk ekziston një përshkrim unik i profilit të të miturve në konflikt me ligjin, pasi një sjellje antisociale shfaqet si pasojë e ndërthurjes së faktorëve psikologjikë, familjarë dhe socialë shumë të ndryshëm rast pas rasti.³⁷

Në rrënjën e tendencës antisociale, ka gjithmonë një mungesë, qoftë thjeshtë nga një impuls i dhënë nga nëna ku ajo ka qënë e mbyllur në vetëvete, e ligështuar, qoftë kur familja ka qënë jokompakte apo ka tendenca antisociale. Ka gjithmonë një bërthamë të shëndoshë e menjëherë një ndërprerje, pas së cilës gjërat nuk kanë qënë më si më parë. Duket sikur fëmija antisocial kërkon në një mënyrë, apo në një tjetër të bëjë të njohur borxhin që bota ka ndaj tij, apo duke u përpjekur që bota të riparojë atë që ka shkatërruar.³⁸

3.1. Mosha e delikuentëve kryerës të mitur në RMV-ut

Përsa i përket ndarjes së të miturve në grup mosha, legjisalcionet e vendeve të ndryshme e kanë të rregulluara në mënyra të ndryshme dhe jo të njetë, parashohin mosha të ndryshme të pjesëmarrësve në aktet kriminale.³⁹

Studiuesit përpiqen të shpjegojnë shkaqet e ndryshueshmërisë së krimit në varësi të moshës së tyre. Ata e vëjnë theksin në faktorë të ndryshëm përbërja demografike e popullsisë, rëndësia që ka grup mosha e re në shoqëri, aktiviteti i madh i këtyre moshave, mënyra e kalimit

³⁷ Grup autoresh, Te miturit në konflikt me ligjin, Tirane, 2015, fq-29

³⁸ Po aty

³⁹ Ismail Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 114

të kohës së lirë, kontaktet e shumta me njërin tjetrin etj.⁴⁰

Për qëllime të përgjegjësisë penale për krimet, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën 14 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit.⁴¹ Për qëllime të përgjegjësisë për kundërvajtjet penale, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën 16 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së kundërvajtjes penale. Ndërsa, në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë, në kuptim të këtij Kodi, derisa të përcaktohet mosha e tij.

Instrumentet juridike ndërkombëtare, rekomandojnë shtetet që të përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilët fëmijët prezumohen të papërgjegjshëm për veprimet e veta për të filluar procedura penale ndaj tyre.⁴²

Mosha është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e recidivizmit tek të miturit në konflikt me ligjin. Sa më i vogël të jetë i mituri në momentin e kryerjes së një vepre penale për herë të parë, aq më i rrezikuar është ai për t'i përsëritur ato.⁴³ Në krahasimin mes një kampioni të miturish recidivë dhe një kampioni të miturish jo recidivë në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, Katsiyannis dhe Archwamety (1997) vërejtën se mosha e fillimit të veprave penale dhe mosha e ndalimit për herë të parë nga policia ishin faktorët kryesorë që i diferenconin dy grupet. Veç kësaj, sa më herët të ketë ndodhur institucionalizimi për herë të parë në sistemin penitenciar dhe sa më e hershme të jetë mosha e lirimit, aq më i lartë është rreziku që sjelljet në konflikt me ligjin të përsëriten brenda një kohe të shkurtër

3.2. Mosha e delikuentëve kryerës të mitur në Slloveni

Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar shumë kohë më parë. Këteleja (Quetele) e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit. Tendenca më e theksuar e krimit zhvillohet në proporcion me intensitetin e forcës fizike

⁴⁰ Po aty, faqe 115

⁴¹ N.7, I Kodit të drejtësisë penale për të mitur të R.Shqiperisë

⁴² Konventa e të Drejtave të Fëmijëve, neni 3 (a),

⁴³ Save the Children, shkaqe dhe faktorë shoqëruarës të sjelljeve kriminale përsëritëse (përthim), Tiranë, 2015

dhe pasionin e personit⁴⁴. Në përgjithësi është pranuar se në vendet ku ka probleme të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve, të mungesës së rendit dhe të stabilitetit politik dhe ekonomik, mundësitë e përfshirjes në krim në moshë të hershme janë të mëdha⁴⁵.

Studiuesit përpiqen të shpjegojnë shkaqet e ndryshueshmërisë së krimit në varësi të grup moshës dhe faktorët që ndikojnë në përhapjen e krimeve në moshat e reja. Ata e vënë theksin në faktorë të ndryshëm, ndër të cilët më të rëndësishmit janë: përbërja demografike e popullsisë, rëndësia që ka grup moshë e re në shoqëri, aktiviteti i madh i këtyre moshave, mënyra e kalimit të kohës së lirë, kontaktet e shumta të të rinjve me njëri tjetrin, etj⁴⁶.

Sipas n.72, të Kodit penal të Republikës së Sllovenisë, kundër të miturve që në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur 14 vjet por ende nuk e ka arritur moshën 16 vjeçare, mund të shqiptohen vetëm masat edukuese.

3.3. Gjinia e delikuentëve kryerës të mitur të veprave penale

Karakteristikë e delikuencës së të miturve është se me kriminalitet merren si meshkujt ashtu edhe femrat. Shënimet statistikore gati në të gjitha vendet e botës tregojnë se po rritet pjesëmarrja e femrave të mitura në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme kriminale, siç është marrja me prostitucion, marrja me bixhoz, kontrabanda me drogë dhe forma të reja të sjelljeve të rrezikshme kriminale.⁴⁷

Nga të dhënat statistikore që kanë të bëjnë për personat e akuzuar si kryerës të veprave penale për periudhën 2010-2016 rezulton si vijon;.⁴⁸

⁴⁴ V. Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, faqe 123;

⁴⁵ Po aty;

⁴⁶ V. Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, faqe 123;


⁴⁷ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq-108

⁴⁸ Po aty

Viti 2001 (1446 kryeres te v.p)



Personat e mitur te akuzuar si kryers te v.p 2010-2016



Nga tabela e mësipërme do të vërehet se, pjesëmarrja e femrave është shumë e ulët në krahasim me meshkujt, në të gjitha veprat penale.

Kërkimet kriminologjike lidhur me dukurinë e kriminalitetit kundër pasurisë dhe pjesëmarrjen e femrave në disa krime kundër pasurisë, tregojnë se femrat si kryerës të këtyre krimeve, paraqiten më tepër të disa vjedhje të imta, mashtrime, vjedhje të zakonshme e më pak të krimet e vjedhjeve të rënda, vjedhjeve me armë apo plackitjeve. Pjesëmarrja e femrave në kryerjen e këtyre krimeve sillet në lartësi afër 10% të të gjitha personave të dënuar.⁴⁹

Studimi i autorëve të veprave penale dhe vëmendja e kriminologëve ka ngjallur interesim dhe është drejtuar në studimin e lidhjeve si: femra dhe krimi, të miturit dhe krimi si dhe janë përpjekur të shpjegojnë dallimin e madh që ekziston në përfshirjen e meshkujve dhe të femrave në krim, jo vetëm në vendet perëndimore por edhe në ato në zhvillim ose të Evropës Jug-Lindore⁵⁰. Disproporcioni i përfshirjes së femrave dhe meshkujve në krim është shpjeguar me argumente të ndryshme, si- për disa lloje të veprave penale të kryera nga femrat jo në të gjitha rastet policia i arreston ato (vrasja e foshnjës, moskujdesi ndaj fëmijës, braktisja e fëmijës), roli social i femrës në shoqëri, trajtimi i ndryshëm i saj në shoqëri, struktura biopsiqike e femrës si qenie e cila jo çdo herë u përshtate vështirësive.

4. Gjendja ekonomike e delikuentëve kryerës të mitur në RMV

Situata social-ekonomike e familjes është një nga faktorët më të studiuar që supozohet të parashikojnë recidivizmin të të miturit në konflikt me ligjin. Ka opinione dhe argumente kontradiktorë mes tyre për sa i përket efektit të faktorëve ekonomikë, të cilët kanë të bëjnë kryesisht me të ardhurat e ulëta të familjes, mungesën e punësimit dhe kushtet e papërshtatshme të banesës, mbi sjelljet kriminale të të miturve.⁵¹ Të miturit që jetojnë në familje me një prind (kryesisht me nënën) vuajnë mungesën e qëndrueshmërisë së figurës mashkullore dhe kjo është e lidhur fort sidomos me sjelljet problematike të adoleshentëve

⁴⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, faqe 209

⁵⁰ V. Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, faqe 123;

⁵¹ Save the Children, shkaqe dhe faktorë shoqëruarë të sjelljeve kriminale përsëritëse (përkthim), Tiranë, 2015

meshkuj. Të miturit që vijnë nga familje të mëdha kanë më pak mundësi për vëmendjen dhe disiplinimin pozitiv nga të dy prindërit dhe jetesa në të tilla kontekste familjare do të thotë më shumë vështirësi ekonomike dhe ndikim më të pakët prindëror për sa i përket kontrollit mbi sjelljet e qëndrimet problematike të fëmijëve dhe shoqërimin me moshatarë deviantë.

Fëmijët që jetojnë në lagje të varfra, të izoluara, me infrastrukturë jo të përshtatshme dhe nivel të lartë papunësie dhe informaliteti, kanë rrezik të lartë ta konsiderojnë krimin si një mënyrë për të dalë nga kjo gjendje dhe për të qenë të suksesshëm.⁵² Në një komunitet të çorganizuar, institucionet informale dhe formale shoqërore si familja, shkolla, fqinjët, policia etj., nuk funksionojnë efektivisht në socializimin e të rinjve dhe në ruajtjen e rregullit dhe respektimin e normave sociale; ato humbasin aftësinë për të kontrolluar sjelljen e anëtarëve duke stimuluar zhvillimin e vlerave dhe kulturës së krimit sepse adoleshentët nuk njohin rregulla të tjera të sjelljes përveç atyre që përmbushin interesat e tyre.

Sipas dhënave të Institutit për demokraci sociale "progress". Anketa e këtij institute ka treguar se tre të katërtat e familjeve në Maqedoni mund të mbulojnë me buxhetin e tyre mujor vetëm shpenzimet për ushqim dhe faturat e shtëpisë, ndërkohë që më shumë se gjysma e qytetarëve konsiderojnë që pushteti e shpenzon buxhetin në dobi të tij dhe jo në dobi të qytetarëve, ndërsa dy të tretat e qytetarëve mendojnë që qeveria po e menaxhon keq problemin e varfërisë dhe të papunësisë.⁵³ Në anketë janë përfshirë, 1116-të anketuar, ndërsa është realizuar muajin shkurt nëpërmjet telefonit. Të dhënat tregojnë se sipas strukturës etnike, 72,4 % , nga të anketuarit janë maqedonas, ndërsa 23%, janë shqiptarë. Sipas të ardhurave mujore, 11,4% marrin të ardhura prej 6000 deri 10.000 denarë, ndërsa 27,6 % marrin nga 10.000 deri në 20.000 denarë. Në pyetjen nëse qeveria po e shpenzon buxhetin e shtetit në dobi të qytetarëve ose në dobi të saj, 18,5% nga të anketuarit janë përgjigjur se qeveria e shpenzon buxhetin për qytetarët, ndërsa më shumë se gjysma e tyre, 54% janë përgjigjur se qeveria e shpenzon buxhetin për të mirat e saj.

⁵² Po aty

⁵³ Ismail Zejneli, vep, e cituar.

Papunësia është e ngjashme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësimin e kyçjes në punë të njerëzve e, kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Kriminologu i njohur francez Konstant, papunësinë dhe problemet të cilat krijohen tek individët dhe familjet, i konsideron si faktorë dhe rrethanë që i paraprinë krimit në shoqëri. Papunësia edhe problemet që ndërlidhen me ta, veçmas ndikojnë në paraqitjen e delikuencës së të miturve dhe kriminalitetit të të rinjve⁵⁴.

4.1. Gjendja ekonomike e delikuinteve kryeres te mitur ne Slloveni

Ekonomia e Sllovenisë është e vogël, e hapur, dhe e orientuar nga eksporti dhe ka qenë e ndikuar fuqishëm nga kushtet ndërkombëtare. Ajo u dëmtua rëndë nga kriza e Eurozonës, që filloi në fund të viteve 2000. Fusha kryesore ekonomike është ajo e shërbimeve e pasuar nga industria dhe ndërtimi.⁵⁵

Me **zhvillim ekonomik** Sllovenia përkujton Zvicrën. Me pasuri natyrore që ka, Sllovenia nuk i plotëson nevojat e vendit. Ajo shquhet për potencial të konsiderueshëm të hidroenergjisë, por jo edhe për rezervat e qymyrit dhe të naftës. Prodhimtaria vjetore e qymyrit është 5,5 milion tonë dhe nuk i plotëson nevojat e ekonomisë së vendit. Qymyri është i kualitetit të dobët, përkatësisht është llojit të linjitit. Prodhimtaria vjetore e naftës është më tepër simbolike me 2 000 ton. Baza energjetike e Sllovenisë është 12 miliard kWh, e përfituar në pjesën më të madhe nga energjia e ujit, centralit bërthamor në Kërshko dhe më pak nga qymyri. Mirëpo edhe kjo bazë e energjisë nuk i plotëson kërkesat gjithnji më të mëdha të industrisë së vendit. Këtë deficit në energji e plotëson me import nga shtetet fqinje.

Kërkimet kriminologjike, në këtë drejtim flasin për përqindjen e madhe të të miturve delikuent të cilët rrjedhin nga familjet ku ka pasur raporte jo të mira ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Sjelljet tepër rigoroze, dënimet e vrazdhda ndaj fëmijëve dhe të miturve, aplikimi i

⁵⁴ Po aty;

⁵⁵ Wikipedia

rafjes, dënimit fizik, torturave dhe presioneve psikike ndaj fëmijëve kanë ndikuar në mënyrë negative në formimin e fëmijëve dhe të miturve.⁵⁶

Përgjithësisht mund të konstatojmë se gjendja ekonomike në Republikën e Sllovenisë si anëtare e Bashkimit Evropian dukshëm është më e mirë se sa ekonomia në R.Maqedonisë së Veriut.

Krizat dhe depresionet ekonomike, trajtohen si faktorë që kanë ndikim të dukshëm në sjelljet kriminale të të miturve. Rezultatet e kërkimeve dhe studimeve empirike të raporteve në mes krizave ekonomike dhe kriminalitetit tregojnë se, në disa raste këto rrethana ndikojnë dukshëm në shtimin e disa formave të kriminalitetit të të miturve, si: vjedhjet, mashtrimet, abuzimet, tregtia e palejuar, prostitucioni, etj⁵⁷.

5. Politikat e BEsë lidhur me varfërinë fëminore-

Raporti i Agjencisë së BEsë për të drejta fundamentale (i vj-2009), përmban tregues specifik të cilët e masin mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Përfaqëson një manual mjetesht për ta vlerësuar ndikimin e ligjit dhe politikës së BEsë mbi statusin e fëmijëve dhe eksperiencën në sferat e ndryshme; treguesit e prezantuar në raport gjithashtu kanë për qëllim që ta nënvizojnë zbrastirën ekzistuese në rregulloret dhe të dhënat aktuale të BEsë.

Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është ndërmarrë nga Komisioni Evropian në 2006, përmes Komunikatës së tij “Drejtë një strategjie mbi të drejtat e fëmijëve”, e cila paraqet një qasje koherente, përfillëse në zhvillimin, aplikimin, vëzhgimin dhe shqyrtimin e ligjit dhe politikës së BEsë, me ndikim mbi fëmijët. Kjo strategji bazohet në një sërë të objektivave specifike përfshirë edhe nisjen e Planit veprues për fëmijët në bashkëpunimin zhvillimor, krijimi i një forumi evropian për të drejtat e fëmijëve, etj

Në plotësim të Komunikatës paraprake, duhet të shtohet se në Raportet kombëtare 2006-2008 për strategjitë për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale, qeveritë e shteteve anëtare të BEsë,

⁵⁶ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, f.282

⁵⁷ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 246;

janë zotuar të krijojnë një qasje strategjike, të integruar dhe afatgjate për parandalim dhe adresim të varfërisë dhe ç'kyçjes sociale mes fëmijëve; kjo u plotësua (në janar 2008) me raportin “Varfëria dhe mirëqenia fëmimore” të miratuar nga Komiteti për mbrojtje sociale i BEsë.

Kapitulli IV

1. Parandalimi i kryerjes së veprave penale nga ana e te miturve

Termi prevencion (parandalim), është huazuar në mënyrë pragmatike nga vokabulari dhe praktika mjekësore. Në kuptimin e vetë të gjerë janë profiluar dy përmbajtje themelore të këtij nocioni. I pari prej tyre ka të bëjë me intervenimin si formë primare e prevencionit. Kjo qasje në esencë ka shënuar intervenimin ndaj dukurive të caktuara me mjete të përcaktuara që më parë. Përmbajtja e dytë lidhet me prefiksin që shënon reaksionin e parakohshëm, më saktësisht reaksionin para se të jetë manifestuar dukuria e padëshiruar.⁵⁸ Në gjuhën latine, *praeventio* (*prae-venio, veni, ventum, praeventus, praevenire*) shënon përcaktimin dhe termin e kaloj, arrijë përpara, e kapërcej një dukuri të caktuar, ose si siç do të mund të thuhej në bazë të mendjes së shëndoshë parandalim, mbrojtje paraprake, pengim, shmangie që më parë. Që nga shekulli XV në praktikën angleze socio – politike dhe kriminale – politike përdoret shprehja *prevent* me të cilën dëshirohet të theksohet çdo përmbajtje me të cilën në periudhën e ardhshme do të pengohen sjelljet e dënueshme në kuptim të ngushtë të përcaktimit të tyre.

Qëllimi i parandalimit të kriminalitetit është pengimi i një vargu të tërë të veprimeve të ndryshme kriminale siç janë: deliktet pasurore, deliktet lidhur me drogën, deliktet e dhunës pastaj, sot për opinionin delikti interesant dhe shumë i shfrytëzuar nga ana mediale i kriminalitetit të organizuar. Këtë po e apostrofojmë në mënyrë që të kuptojmë se është fjala për forma dhe aktivitete shumë përmbajtjesore që është vështirë të përfshihen me një masë ose me një instrumentarium unik, dhe nga ky aspekt mund të flitet për lloje të ndryshme të parandalimit të kriminalitetit.

Parandalimi dhe ndërhyrja janë dy koncepte të ndryshme. Parandalimi nënkupton marrjen e masave për të mos lejuar shfaqjen e problemit dhe drejtohet ndaj të gjithë popullatës. Ndërhyrja realizohet me individët më të rrezikuar, apo të përfshirë në sjellje

⁵⁸ Ismail Zejneli, *Delikuenca e te miturve*, Tetove, 2018, fq-160

kriminale dhe synon reduktimin apo eliminimin e sjelljeve problematike.⁵⁹ Parandalimi i hershëm redukton gjasat që të miturit të përfshihen në sjellje problematike. Programet primare parandaluese përfshijnë të gjithë të miturit dhe jo vetëm ata që shfaqin sjellje kriminale. Përveç këtyre programeve ekzistojnë dhe programe parandaluese dytësore të cilat përfshijnë të miturit që kanë shfaqur tendenca për tu përfshirë në sjellje kriminale. Për të miturit të cilët janë përfshirë në sjellje kriminale ndërtohen programe specifike trajtimi.

Ekzistojnë programe të ndryshme, të cilat kanë rezultuar të suksesshme për parandalimin dhe trajtimin e sjelljeve delinkuente. Në përgjithësi programe efikase konsiderohen ato që:

- Identifikojnë faktorët e riskut dhe ata mbrojtës, ndaj të cilëve janë të ekspozuar të miturit.

- Fokusohen më shumë tek të miturit e ekspozuar ndaj faktorëve të riskut.

- Ofrojnë ndërhyrje në plane/drejtime të ndryshme.

- Janë intesive dhe të vazhdueshme.

- Marrin në konsideratë pikat e forta dhe të dobëta të të miturve.⁶⁰

2. Roli i gjykatës në parandalimin e delikuençes së të miturve

Gjykata është subjekt themelor i procedurës penale. Ajo në procedurë penale e ushtron funksionin e gjykimit, mirëpo funksioni i saj nuk kufizohet vetëm në funksionin e gjykimit. Gjykata si organ i pavarur gjykon në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.⁶¹

⁵⁹ Grup autoresh, Te miturit në konflikt me ligjin, Tirane, 2015, fq-35

⁶⁰ Po aty

⁶¹ Ejup Sahiti&Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e R.Maqedonise, Shkup 2017, fq-68

Ndaj të miturit kryerës të veprës penale mund të shqiptohen sanksionet vijuese: - masat edukuese, - dënimet, - masat alternative dhe sanksionet për kundravajtje. Thënë më konkret, ndaj të miturit të ri mund të shqiptohen vetëm masa edukuese; ndaj të miturit të moshuar mund të shqiptohen masat edukuese, e përjashtimisht edhe dënimi ose masa alternative. Nën kushtet e përcaktuara me Kod penale ndaj të miturit gjithashtu mund të shqiptohet masë e sigurimit apo konfiskimi i dobisë pronësore ose i sendit.

Çdo person ka të drejtë që një gjykatë e pavarur dhe e paanshme të vendosë brenda një kohe të arsyeshme mbi të gjitha çështjet e lidhura me të drejtat dhe detyrimet e tij dhe me akuzën penale të ngritur kundër tij(n.6 I KEDNJ)

Sipas nenit 98 paragrafi 5 të Kushtetutës së RM lloji, kompetenca, themelimi, abrogimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, përcaktohet me ligj, që nxirret me shumicën e dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetve .

Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarë profesionalë dhe gjyqtarë porotë. Varësisht nga rëndësia e çështjes penale, për ndriçimin dhe zgjidhjen e saj, ekziston trupi i madh gjykues i përbërë prej dy gjyqtarësh profesionalë dhe tre gjyqtarëve porotë (gjykon në shkallë të parë veprat për të cilat është paraparë dënimi burgim prej pesëmbëdhjetë vjetësh ose burgim i përjetshëm) dhe, trupi i vogël gjykues i përbërë nga një gjyqtarë profesional dhe dy gjyqtarë porotë (gjykon në shkallë të parë veprat penale ku është paraparë dënimi burgim më i lehtë si dhe në shkallë të dytë kur hapet shqyrtimi gjyqësor). Siç shihet përbërja e trupit gjykues është mikste me gjyqtarë profesionalë dhe gjyqtarë porotë. Si të tillë e hasim në shqyrtim gjyqësor (përveç kur shqyrtimin gjyqësor e zhvillon gjyqtari i vetëm), kurse kolegjin e hasim jashtë shqyrtimit gjyqësor. Ekziston edhe *trupi gjykues për të mitur*, i cili në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë gjykon në përbërje prej gjyqtarit për të mitur dhe dy gjyqtarëve porotë.⁶²

Në Republikën e Maqedonisë në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar është formuar sektori i specializuar për kriminalitetin e të miturve, i përbërë nga: gjykatësi për të

⁶² Po aty

mitur, këshilltarët për të mitur dhe këshillat për të mitur.(Neni 44 i Ligjit mbi drejtësimë për të mitur, (“Gazeta zyrtare e RM-së”, nr. 87/2007);

Këshilli për të mitur në gjykatën themelore përbëhet nga gjykatës për të mitur dhe dy gjykatës porot, ku gjykatësi për të mitur është edhe kryetar i Këshillit. Gjykatësit porotë zgjedhen nga radhët e punonjësve të arsimit-psikologëve, sociologëve dhe personave tjerë të cilët kanë përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjëve. Këshilli për të mitur në gjykatën themelore vendos në shkallë të parë në procedurën për veprat penale si dhe për ankesat kundër vendimeve të gjykatësit për të mitur dhe në raste të tjera të parashikuara me këtë ligj. Ndërsa, Këshillat për të mitur të Gjykatës së Apelit i përbërë nga gjykatësi për të mitur dhe dy gjykatës, vendos për ankesat kundër vendimeve të këshillit për të mitur të gjykatës themelore, si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj.(Neni 95 i Ligjit mbi drejtësinë për të mitur;

Qëllimi i trajtimit specifik të të miturve kryerës të veprave penale pikësëpari është që i mituri të risocializohet dhe të kompensohet ajo që në edukimin e tij është lëshuar, në mënyrë që të kthehet si anëtarë i dobishëm i shoqërisë. Trajtimi i posaçëm i kësaj kategorie kryerësish të veprave penale arsyetohet edhe me faktin se, duke e pasur parasysh moshën e re të tyre ka më shumë shpresë për përmirësim, e në anën tjetër se ata edhe një kohë të gjatë do t'i shkaktojnë dëm shoqërisë, po qe se nuk ndërmerren masa për përmirësimin e tyre.⁶³

Gjykata të miturin mund ta dënojë me pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe me plotësimin e kërkesave pronësore-juridike të të dëmtuarit në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale, vetëm kur të miturit i është shqiptuar dënim ose masë alternative. Nëse ndaj të miturit është zbatuar masë edukuese, shpenzimet e procedurës bien në barrë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përveç kur të miturit i është shqiptuar detyrim i veçantë për kompensimin e dëmit (neni 38 paragrafi 2 alineja 2) .

Sipas disa të dhënave në Republikën e Maqedonisë reth 85% të veprave penale të kryera nga ana e të miturve janë vepra penale kundër pasurisë, 6% vepra penale kundër jetës dhe trupit, ndërsa 9% janë vepra tjera penale. Është interesant fakti se nga numri i përgjithshëm i veprave

⁶³ Po aty

penale të kryera nga ana e të miturve, 7% i kanë kryer personat e mitur të gjinisë femërore, ndërkaq, 50% të këtyre veprave janë kryer nga ana e personave të mitur të organizuar në banda kriminale⁶⁴.

Burgu për të mitur nuk mund të jetë më i shkurtër se një vjet dhe më i gjatë se dhjetë vjet. Gjatë matjes së dënimit gjyqi nuk mund kryerësit të veprës penale ti shqiptojë dënim për të mitur në kohëzgjatje më shumë se dënimi i përcaktuar me burg për atë vepër (n.87 i Kodi penal i RM-së).

Burgu për të mitur duhet të ketë disa karakteristika të posaçme edhe atë si p.sh.: duhet të jetë shumë pak i ngarkuar me masa represive dhe shtrënguese, por më shumë me masa të përmirësimit si p.sh.: të miturit të dënuar duhet të angazhohen më shumë në punë, në mësim, në aktivitete sportive, kulturore, etj. Në burgun për të mitur organizohet edhe përcjellja e mësimit fillor, zgjedhja e ndjekjes së mësimit varet para së gjithash nga vetë mundësia e burgut. Në ato ente ku nuk ka kushte për organizimin e mbajtjes së mësimit, mësimin të miturit do ta ndjekin në shkollën e qytetit në të cilin e vuajnë dënimin⁶⁵.

⁶⁴ S. Aleksoski, Kriminalna psihologija, Shtip, 1997, faqe 13;

⁶⁵ Zoran Sulejmanov, Penologija, Shkup, 1999, faqe 787 ;

Gjykata të miturin mund ta dënojë me pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe me plotësimin e kërkesave pronësore-juridike të të dëmtuarit në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale, vetëm kur të miturit i është shqiptuar dënim ose masë alternative. Nëse ndaj të miturit është zbatuar masë edukuese, shpenzimet e procedurës bien në barrë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përveç kur të miturit i është shqiptuar detyrim i veçantë për kompensimin e dëmit (neni 38 paragrafi 2 alineja 2) .

Ndaj të miturit të rritur kryerës i përgjegjshëm i veprave penale përjashtimisht mund të shqiptohet edhe dënimi me gjobë nën kushtet e përcaktuara me Ligjin mbi kundravajtjet. Dënimi me gjobë për kundravajtje mund të përcaktohet në shumë e cila nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro kundërvlerë në denarë e as më e madhe se 800 euro në kundërvlerë në denarë.

Gjykata mund që të miturit të rritur përgjegjës për veprën penale për të cilën është paraparë dënim me të holla ose dënim me burgim prej tre vjetësh, t'i shqiptojë masë punë në dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej pesë deri 100 orë kur është e nevojshme që me këtë masë të bëhet ndikim edukues ndaj personalitetit dhe sjelljes së të miturit. .

Nëse i mituri nuk i plotëson ose në mënyrë jo të rregullt i plotëson obligimet e urdhëruara të punës, gjykata do ta zëvendësojë këtë masë me masën dërgim në qendër disiplinore për të mitur ose me masën e mbikëqyrjes së përforcuar, nën kushtet e parapara për shqiptimin e tyre, duke marrë parasysh pjesën e obligimeve të cilat janë plotësuar. (n.56 i LPM i RM-së)

Në vijim do të parqesim të dhëna statistikore lidhur me numrin e personave të mitur të dënuar sipas veprave penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2008-2017.

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	715	748	547	722	556	473	461	348	468	368
Veprat penale kundër	44	49	59	79	43	39	47	43	70	29

jetës dhe trupit										
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	2	4	1	5	1	5	-	2	7	2
Veprat penale kundër nderit dhe autoritetit	/	1	/	2	/	/	/	1	/	/
Veprat penale kundër lirive gjinore dhe moralit gjinor	16	14	7	12	8	5	14	13	7	2
Veprat penale kundër shëndetit të njerëzve	5	6	7	15	7	12	4	7	13	7
Veprat penale kundër martesës, familjes dhe rinisë	/	/	1	1	/	1	1	/	2	/
Veprat penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	6	4	13	7	9	3	3	5	4	1
Veprat penale kundër pasurisë	529	547	403	513	409	353	267	198	257	251
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme së njërëzve dhe pronës	7	2	1	6	4	4	6	2	2	2

Veprat penale kundër sigurisë në komunikacion	50	46	35	39	26	24	14	28	22	32
Veprat penale kundër rendit publik	16	45	16	35	43	25	100	42	79	37
Vepra tjera penale	3	10	3	7	5	2	5	6	4	3

Nga tabela e mësipërme do të vërehet se, të miturit më së shumti kanë kryer vepra penale kundër pasurisë. Sipas viteve, më shumti vepra penale kundër pasurisë të miturit kanë kryer në vitin 2008- me gjithsej 547 vepra të kryera, ndërsa më pak vepra të kryera vërehet në vitin 2015, gjithsej 198.

2.1. Karakteristikat e procedurës ndaj të mitur

Kriminaliteti si dukuri shoqërore negative nuk është karakteristikë vetëm e popullatës së të rriturve. Shpeshherë si kryerës të veprave penale paraqiten edhe personat e mitur. Mirëpo, duhet theksuar se zhvillimi i gjithanshëm fizik e psikik i personave të mitur dallon nga zhvillimi i personave të rritur dhe karakterizohet me një intensitet të lartë si për sa i përket rritjes së tyre ashtu edhe për sa i përket lëkundshmërisë lidhur me vlerat shoqërore.⁶⁶ Për shkak të papjekurisë së tyre, në ta mund të ndikohet si në aspektin pozitiv po ashtu edhe në atë negativ. Për këtë arsye në rastin kur të miturit kryejnë vepra penale, të drejtat bashkëkohore parashohin rregullim të posaçëm për trajtimin e tyre. Qëllimi i trajtimit specifik të të miturve kryerës të veprave penale pikësëpari është që i mituri të risocializohet dhe të kompensohet ajo që në edukimin e tij është lëshuar, në mënyrë që të kthehet si anëtarë i dobishëm i shoqërisë. Trajtimi i posaçëm i kësaj kategorie kryerësish të veprave penale arsyetohet edhe me faktin se, duke e pasur parasysh moshën e re të tyre ka më shumë shpresë për përmirësim, e në anën tjetër se ata edhe një kohë të gjatë do t'i shkaktojnë dëm shoqërisë, po që se nuk ndërmerren masa për përmirësimin e tyre

Në procedurë ndaj të miturve për vepra penale dhe për kundravajtje, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, përshtatëshmërisht zbatohen dispozitat e LPP-së dhe të Ligjit për kundravajtje sa u përket: parimeve themelore, gjuhës, kompetencës territoriale, pasojës së jokompetencës dhe konfliktit të kompetencës, përjashtimit, të pandehurit, mbrojtësit, shkresave, procesverbaleve, rivendosjes së afatit, shpenzimeve, kërkesës pronësore juridike, marrjes dhe komunikimit të vendimeve, dorëzimit të shkresave, thirrjes, shoqërimit, ndaljes së personit, dorëzimit dhe marrjes së lejes së udhëtimit nga i huaji, marrjes në pyetje të dëshmitarëve, këqyrjes, ekspertimit, kontrollit të lokaleve dhe personave, mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.(Neni 79 i LDMM).

Në nenet 3-11 të Ligjit për drejtësinë për të mitur janë përcaktuar parimet themelore për sa i përket procedimit ndaj të miturëve kryerës të veprave penale. Në rend të parë është -

⁶⁶ Ejup Sahiti&Ismail Zejneli, E drejta e procedurës penale e R.Maqedonise, Shkup 2017, fq-315

parimi i legalitetit *nulum crimen nulla poene sine lege*; - Me rastin e ushtrimit të veprimeve qofshin ato joformale apo procedurale gjyqësore i mituri gëzon të drejtat e njejta që i gëzon i rrituri i pandehur për vepër penale apo për kundërvajtje; Masat, ndëshkimet dhe veprimtaria ndaj të miturëve në rend të parë duhet të kenë parasysh interesin e të miturit për mbrojtje, edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë të tij dhe me rastin e masave dhe dënimeve mund të kufizohen të drejtët e caktuara vetëm në masë që i përgjigjen shkallës së zhvillimit, të personalitetit dhe nevojës për menjanimin e rrethanave që kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale apo të kundërvajtjes; nga masat dhe sanksionet e parapara përparësi kanë masat preventive, mbrojtëse dhe edukuese, ndërsa sanksionet që kanë të bëjnë me kufizim të lirisë aplikohen përjashtimisht; procedura penale zhvillohet vetëm në rastet kur i mituri ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej tre vjetësh ose dënim më i rëndë, ose kur qëllimi i masave ose i dënimit nuk mund të arrihet pa një procedurë të tillë; i mituri ka të drejtë në mbrojtje para gjykatës kompetente kundër vendimeve të marra në procedurë administrative; e drejtë themelore e të miturit është që sanksioni të shqiptohet nga gjykata kompetente, ndërsa masat tjera mund t'i shqiptojë edhe organi tjetër i specializuar.⁶⁷

Në procedurë ndaj të miturve për vepra penale dhe për kundërvajtje, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, përshtatëshmërisht zbatohen dispozitat e LPP-së dhe të Ligjit për kundërvajtje sa u përket: parimeve themelore, gjuhës, kompetencës territoriale, pasojës së jokompetencës dhe konfliktit të kompetencës, përjashtimit, të pandehurit, mbrojtësit, shkresave, procesverbaleve, rivendosjes së afatit, shpenzimeve, kërkesës pronësore juridike, marrjes dhe komunikimit të vendimeve, dorëzimit të shkresave, thirrjes, shoqërimit, ndaljes së personit, dorëzimit dhe marrjes së lejes së udhëtimit nga i huaji, marrjes në pyetje të dëshmitarëve, këqyrjes, ekspertimit, kontrollit të lokaleve dhe personave, mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.(Neni 79 i LDM.).

Mbrojtja në të gjitha fazat e procedurës për të mitur është e detyrueshme – neni 82-a i LDM.

⁶⁷ Po aty

I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë. Sipas rregullit prezenca e të miturit në seancë duhet siguruar nëpërmjet prindit respektivisht përfaqësuesit ligjor - neni 91 i LDM.

Në procedurë për të mitur askush nuk mund të lirohet nga detyra për të dëshmuar për rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit shpirtëror të të miturit, për njohjen e personalitetit të tij dhe të kushteve në të cilat jeton - neni 87 i LDM

Me rastin e trajtimit të parimit të publicitetit është theksuar se në procedurë për të mitur nuk ka publicitet. Rrjedhimisht, sipas nenit 92 të LDM kur gjykohet i mituri publiku gjithëmonë përjashtohet.

Procedura për të mitur duhet të zhvillohet me urgjencë. Sipas nenit 93 të LDM organet që marrin pjesë në procedurë ndaj të miturit, si dhe organet tjera prej të cilave kërkohen njoftime, raporte ose mendime, kanë për detyrë që t'ia dorëzojnë gjykatës në kohë sa më të shkurtër, po jo më vonë se njëzetë ditë .

3. Roli i policisë në parandalimin e e delikuenes se te miturve

Në çdo shoqëri të organizuar në shtet policisë i takon vend i posaçëm në luftë kundër kriminalitetit. Në të vërtetë, në luftë kundër kriminalitetit policia gjendet në vijën e parë të frontit. Për kundërvënie me sukses ndaj kriminalitetit policia është e thirrur që të ndërmarr një aktivitet të parapërcaktuar.⁶⁸ . Autorizimet e policisë nuk janë çdoherë të njëjta, bile as në kuadër të një shteti në distanca kohore dhe janë të kushtëzuara me qëndrime dhe zgjidhje kriminalo politike në luftë kundër kriminalitetit. Detyrë për t'iu kundërvuar kriminalitetit kanë edhe subjekte të tjera shtetëror, të cilët me rastin mësimi se në atë organ është kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, kanë për detyrë të bëjnë kallëzimin e saj.

Në pajtim me nenin 5 të Ligjit për policinë, zyrtarët policorë janë të detyruar të veprojnë për mbrojtjen e jetës, sigurisë personale dhe pronës së qytetarëve, për pengimin e kryerjes së veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprës, si dhe për

⁶⁸ Ejup Sahiti&Ismail Zejneli, E drejta e procedures penale e R.Maqedonise, Shkup,2017, fq-220

ndërmarrjen e masave të tjera për përndjekjen e autorëve të atyre veprave, të përcaktuara me ligj, si edhe për veprat e tjera.

Gjatë paraqitjes së rastit, zyrtari kujdestar policor është i detyruar të sigurojë sa më shumë informacione dhe të dhëna për rastin, për shkallën e rrezikut, për urgjencën dhe seriozitetin e tij.

Zyrtari kujdestar policor duhet:⁶⁹

- ta përcaktojë vendin e thirrjes,
- të sigurojë të dhëna për paraqitësin/autorin e veprës/viktimën,
- për atë se çka, ku dhe kur ka ndodhur ngjarja dhe a ekziston rrezik momental për shëndetin dhe jetën e dikujt,
- ta përcaktojë se a është lënduar dikush dhe a ka nevojë për ndihmë mjekësore,
- ta përcaktojë se a ka armë dhe a ekziston kërcënim për përdorimin e saj,
- ta përcaktojë se a ka fëmijëve të pranishëm dhe a ka nevojë për strehimin e tyre,
- të bëjë përshkrimin e autorit (pamja dhe veshja), ndërsa në rast të ikjes nga vendi i ngjarjes, duhet të përcaktohet orientimi në të cilin ai ka ikur dhe me çka ka ikur (veturë, motor, në këmbë etj.)

Gjatë veprimit të zyrtarëve policorë me fëmijët viktime, duhet të mbahet llogari për vetë marrëdhënien ndaj fëmijës që mos të shkaktohen pasoja më të mëdha se ato që janë shkaktuar nga vetë vepra penale.⁷⁰ Pasojat e marrëdhënies joadekuate nuk janë të tilla vetëm për integritetin moral, psikik, madje edhe fizik të fëmijës viktimë, por edhe në raport me “mospërdorimin” e deklaratës si dëshmi gjatë procedurës, me çka dëshmimi i veprës penale është pamundësuar ose, së paku, është vështirësuar.

⁶⁹ PROCEDURA për veprim me fëmijën – viktimë. – Kavadarë: Këshilli për parandalim të delikuencës së të miturve - KPDM, 2014.

⁷⁰ Po aty

Sipas LPP nëse ekzistojnë *bazat për dyshim* se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia ka për detyrë, qoftë me vetiniciativë ose me kërkesë të prokurorit publik, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të gjendet kryerësi i veprës penale, që kryerësi ose ndihmësi i tij të mos fshihet ose të mos ikën, të gjejë dhe të ruaj gjurmët e veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si provë, si dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdorën në procedurë penale (neni 276 paragrafi 1).

Për të kryer detyrat e sipërshënuara policia mund:

1° të kërkojë informacione të nevojshme nga qytetarët;

2° të ndalojë, legjitimojë dhe të kryej kontroll të përkohshëm të automjeteve, të udhëtarëve dhe të valigjeve të tyre;

3° që për kohë të nevojshme të kufizojë lëvizjen e personave dhe të mjeteve transportuese në vendin e caktuar;

4° të ndërmarrë masat e nevojshme lidhur me identifikimin e personave dhe të sendeve;

5° të ndërmarrë masa të nevojshme për të gjetur personin ose sendin i cili kërkohet;

6° që në praninë e personit zyrtar ose përgjegjës të kontrollojë objektet dhe lokalet e organeve shtetërore, institucioneve që kryejnë autorizime publike dhe personave tjerë juridikë dhe të realizojë kontroll në dokumentacionin e tyre;

Procedura që zhvillohet për vepra penale në të cilat fëmijët paraqiten si viktimë në të gjitha fazat, përfshirë edhe procedurën policore, është urgjente.

Në vitin 1998, në Raportin e saj të 9-të të Përgjithshëm, (Komiteti për parandalimin e torturës) KPT-ja përcaktoi kriteret që drejojnë punën e saj, kur viziton vendet në të cilat “të miturve” (d.m.th. personat nën moshën 18- vjeçare) iu është hequr liria. Në veçanti, ajo identifikon një numër garancish, të cilat iu duhen ofruar të gjithë të miturve që iu është hequr liria, në bazë të legjislacionit penal, si dhe kushtet që duhen siguruar në qendrat e dënimit, të konceptuara specifikisht për të miturit. Duke u mbështetur në përvojat e vizitave të kryera që prej vitit 1998 dhe duke marrë në konsideratë zhvillimet në nivel evropian e universal, Komiteti vlerëson se ka

ardhur koha për t'i rishikuar këto standarde, duke u përqendruar, në këtë fazë, te heqja e lirisë së të miturve, në kontekstin e së drejtës penale.⁷¹

Në fillim, KPT-ja thekson se standardet e saj duhen parë si plotësuese të atyre që parashikohen në instrumentet ndërkombëtare, konkretisht, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, e vitit 1989 dhe Rekomandimi CM/Rec (2008) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për Rregullat evropiane për shkelësit e mitur, që janë subjekt i sanksioneve ose masave ("Rregullat evropiane për shkelësit e mitur"), që parashikon një grup rregullash të hollësishme për trajtimin e shkelësve të mitur në Evropë². Komiteti pajtohet tërësisht me parimet kryesore të përcaktuara në Nenet 3 dhe 37.b të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe me Rregullat 5 dhe 10 të Rregullave Evropiane për shkelësit e mitur, konkretisht, që në të gjithë aksionin që ka të bëjë me të miturit, konsiderata kryesore është interesi i tyre më i mirë dhe se atyre iu duhet hequr liria si hap i fundit dhe për periudhën më të shkurtër të mundshme.⁷²

4. Roli i qedres për punë sociale në parandalimin e e delikuentes se te miturve

Qendrat për Punë Sociale, për sa i përket fushës së punës, bien në sektorin e mbrojtjes sociale në Ministrinë e Punës dhe Punës Sociale. Sipas legjislacionit, Qendra për Çështjet Sociale funksionon si një institucion profesional me autorizime publike për kryerjen e veprimtarive të mbrojtjes sociale.

Qendra për punë sociale kryen këto aktivitete:

- vendos për të drejtat e mbrojtjes sociale,
- vendos për çështjet e përcaktuara nga rregulloret e ligjit familjar,
- vepron për çështjet e përcaktuara nga rregulloret e ligjit penal,

⁷¹ Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtitimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT) Këshilli i Evropës

⁷² Po aty

- kryen veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjatë kryerjes së mbrojtje sociale dhe punë profesionale, qendra:

- zbulon, monitoron dhe studion dukuritë dhe problemet shoqërore,
- zbaton dhe zbaton format e duhura të mbrojtjes sociale dhe ndihmon drejtpërdrejt një qytetar, familje ose grup të popullsisë,
- zhvillon punë parandaluese,
- zhvillon dhe zbaton forma jo-institucionale të mbrojtjes sociale,
- inkurajon, organizon dhe koordinon vullnetarisht qytetarët, shoqatat e tyre, organizatat humanitare, organizatat në zbatimin e programeve të mbrojtjes sociale, si dhe
- kryen veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj.

Qendra për Punë Sociale është e obliguar që të ndërrmer masa të nevojshme për mbrojtjen e personalitetit, të drejtat dhe interesat e fëmijëve. Çdo qytetarë, person juridik dhe organizatë është i obliguar ta njoftoj Qendrën për Punë Sociale nëse ka njohuri që prindi nuk e kryen të drejtën prindore. (n.84-j,I LMFM)

Masën mbikëqyrja e shtuar nga ana e Qendrës për punë sociale, gjykata e shqipton në rast kur prindërit, adoptuesit apo kujdestari nuk janë në gjendje të zbatojnë kontrollin e shtuar ndaj të miturit.

Një veçori tjetër e procedurës për të mitur është kyqja në të e Qendrës për punë sociale. Në të vërtetë, për çdo fillim të procedurës ndaj të miturit, prokurori publik si paditës i vetëm i autorizuar njofton qendren e cila ka të drejtë që të njihet me zhvillimin e procedurës, të bëjë propozime dhe t'i tregojë faktet dhe provat të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë – neni 90 i LDM.

Me vetë faktin se i mituri gjendet apo jeton me prindërit e tij, është më se e nevojshme që organi social të vejë kontakt edhe me prindërit e të miturit, kjo është e nevojshme para së gjithash për rregullimin e rasteve familjare të të miturit në dhënien e udhëzimeve, për punë të mëtejshme me të miturin, në drejtim që të japë përkrahje, rezultateve që i ka realizuar personi zyrtar. Më vonë këta persona janë të detyruar nga ana e tyre ta informojnë personin zyrtar kompetent për zbatimin e masës për rrethanat dhe pengesat, që kanë ndikim negativ në realizimin e saj. Për të gjitha rrethanat në zbatimin e kësaj mase, vetëm personi zyrtar është i obliguar rregullisht ta informojë gjykatën kompetente, e cila varësisht nga rezultatet e arritura mund ta ndërpresë zbatimin e mëtejshëm të saj ,apo këtë masë ta zëvendësojë me masë tjetër⁷³.

5. Roli I mas-mediave në parandalimin e e delikuenes se te miturve

Mjetet e komunikimit masiv e, posaçërisht shtypi dhe mjetet tjera të komunikimit sot kanë rëndësi të madhe në bartjen e kulturës tek të miturit.

“Shtypi i përditshëm, ai revial, gazetatat e ilustruara dhe zbavitëse shpeshherë, me informata të tilla senzacionale, me fotografi dhe ilustrime të rasteve kriminale, sidomos me paraqitjen e përshkrimeve në detaje të rasteve, ngjarjeve, biografive të personaliteteve të ndryshme, sidomos atyre problematike, nga bota e filmit, nga bota e pop dhe rok muzikës, te një kategori e të miturve nxisin dhe shtytin veprimtari kriminale”⁷⁴. Gjithashtu, prezntimi selektiv, senzacional, dramatik, paraqitja e skenave të tmerrshme të vrasjeve, përleshjeve, plaçkitjeve, dhunimeve të një kategorie të njerëzve, sidomos të të rinjëve nxisin motive të ulta, emocione dhe epshe të shfrenuara, psikozë të frikës dhe pasigurisë⁷⁵.

Me gjithë rolin e madhë të mjeteve të komunikimit masiv në edukimin e të miturve, paraqitja e shkrimeve, emisioneve, filmave dhe përmbajtjeve tjera të cilat kanë vlera të dyshimta morale, kontribojnë dukshëm në nxitjen e sjelljeve delikuede dhe kriminale. Shtypi i përditshëm,

⁷³ Zoran Sulejmanov, Penologjia, Shkup, 1999, faqe 800;

⁷⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 264;

⁷⁵ Po aty;

revistat e ndryshme ilustrative, literature”shund”, filmat me përmbajtje dhe porosi të dyshimta, fatkeqësisht në shumë vende shpeshherë edhe dominojnë. Në përmbajen e gazetave dhe filmave shpeshherë dominon dhuna, sjelljet delikuate, pornografia, prostitucioni dhe përmbajtje të tjera të dyshimta.⁷⁶

Nuk ka dilemë se filmat me përmbajtje, kriminalistike, skenat e vrasjeve, vjedhjeve, skenat pornografike, dhunimet si dhe fotografitë erotike, mund të ndikojnë shumë negativisht në sjelljet delikuate të shumë të miturve.

Ndjekja e filmave me përmbajtje provokuese tek të miturit ndikon dëmshëm. Porositë që dërgohen përmes këtyre videoklipeve, video lojrave tek të miturit lënë gjurmë të rënda, ndoshta edhe me pasoja të paparashikuara. Mundësia që disa herë të përcillen këto skena sjell deri te varshmëria për to, të cilat në fillim këto përmbajtje i përcjellin nga kureshtja ndërsa më vonë bëhen të varur nga to. Fatkeqësisht videoklipet me përmbajtje erotike por edhe me përmbajtje pornografike gjenden edhe tek të miturit e shkollave të mesme, por bile edhe tek filloristët.⁷⁷

⁷⁶ Po aty

⁷⁷ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq-127

Përfundimi

Vepra penale nuk kryejnë vetë personat e moshës madhore por kryejnë edhe personat e mitur ne forma dhe rrethana të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Përkundër faktit se për nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore veprat penale të të miturve janë pothuajse identike e në disa raste edhe më të rrezikshme se veprat penale që kryhen nga personat madhorë, mirpo gjithmonë trajtimi i të miturve në të drejtë penale është më i butë dhe më i favorshëm për të miturit pra për personat që janë ndër moshën 18 vjeç.

Në këtë punim shkencor synim im ka qene qe te paraqes një pasqyre krahasuese mbi delikuencën e të miturve, kryerjen e veprave penale nga të miturit duke analizuar se nga cila moshë të miturit fillojnë të shfaqin sjellje asocial dhe devijante, eshte bere edhe analize e gjendjes se te miturve kryeres të veprave penale në R.Maqedonisë së Veriut dhe në R.Sllovenisë, gjithashtu është analizuar edhe profili i kryerësve të mitur të veprave penale, se kush kryen më shumë vepra penale femrat apo meshkujt.

Po ashtu janë ofruar edhe të dhëna lidhur me atë se sa vepra penale janë kryer nga të miturit dhe se cilat lloje të sanksioneve janë shqiptuar më së shumti për të miturit, ne aspektin nacional dhe krahasues.

Në këtë punim kemi shtjelluar edhe parimet bazë të delikuencës së të miturve, ku në detaje kemi elaboruar parimet e ligjshmërisë, parimi i pafajsisë, parimi e mbrotjes nga diskriminimi, parimin i humanizmit si dhe parimin e interesit me të lartë të fëmijës.

Si përfundim, nga hulumtimet e bërë mundemi të themi se veprat penale të kryer nga të miturit janë çdo ditë e më shumë në rritje, dhe duke trajtuar dhe krahasuar legjislacionet e vendeve në rajonë konkretisht legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Republikës së Sllovenisë, vërejmë se legjislacioni i Republikës së Sllovenisë lidhur me trajtimin e delikuentëve të mitur ka një trajtesë më efikase në krahasim me shtetet fqinje, përfshin edhe RMV-ut. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë hulumtimit mbledhjes së të dhënave statistikore për nevojat e punimit kemi vërejtur se në RMV-ut, ka një ngecje të dukshme në efikasitetin e organeve shtetore, vërehen të meta në praktikën, pra kemi jashtëzakonisht

qështje burokratike që duhet të eliminohen me qëllim që organet kompetente shtetërore të punojnë me më shumë efikasitet në planin praktikë.

Po ashtu janë trajtuar edhe masat parandaluese ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, si-
roli i gjykatava në parandalimin e delikuencës së të miturve, roli i prokurorisë në parandalimin e
delikuencës së të miturve, roli i policisë në parandalimin e delikuencës së të miturve, roli i entit
për punë dhe politikë sociale në parandalimin e delikuencës së të miturve, rolin e mediumeve
në parandalimin e delikuencës së të miturve etj.

Bibliografia-

- Ismail Zejneli, ***Delikuenca e të miturve***, Tetovë, 2018
- Bledar Mustafaraj, ***Kriminaliteti i të miturve***, Tiranë
- Ismet, Salii, ***E drejta penale per te mitur***, Prishtine, 1996
- V, Kambovski&I.Zejneli, ***E drejta penale***, Tetovë, 2018
- Ismet Salii, ***E drejta penale***, Prishtinë, 2016
- Ismet Salii ***E drejta penale per te mitur***, Prishtine, 1996
- E.Sahiti&I.Zejneli, ***E drejta e procedurës penale e RM-së***, Tetovë, 2017
- Ragip Halili, ***Kriminologji*** Prishtine, 2016
- Ragip Halili ***Viktiologjia***, Prishtine, 2012
- Vesel Latifi, ***Kriminalistika***, Prishtinë, 2015
- Vesel Latifi ***Kriminalistika e delikuencaes se te miturve***, Prishtine, 1984
- V. Latifi ***Politika kriminale***, Prishtinë, 2008
- V. Latifi ***Kriminaliteti i të rinjëve në Kosovë***, Prishtinë, 1977
- Vasilika Hysi, ***Hyrje në kriminologji me penologji***, Tiranë, 2002
- Zh. Jashovic ***Kriminologjia maloletniçe delikvencije***, Beograd, 1991.
- Grup autorësh ***E drejta penale Evropiane (përkthim)***, Tiranë, 2009
- Kodi nr.06/L-074 Kodi penal i penal i Republikës së Sllovenis
- Kodi i procedures penale te Sllovenise
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë”
- KODI NR. 06/L-006 I DREJTËSISË PËR TË MITUR
- Ligji mbi Drejtësin e femijëve-RMV, 2013
- Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonisë.

- Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues- (KPT) Këshilli I Evropës
- PROCEDURA për veprim me fëmijën – viktimë. – Kavadarë: Këshilli për parandalim të delikuencës së të miturve - KPDM, 2014.
- Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijës
- Deklarata universale për të drejtat e njeriut